

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5921
E hënë, 4 nëntor 2019
çmimi 0.40 €

Thaçi: BE-ja nuk duhet
t'i bëjë gabimet e liderëve
të fillimviteve '90



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", EMRUSH UJKANI

PA ZHVILLIMIN E SEKTORIT PRIVAT VËSHTIRË SE MUND TË KETË RRITJE EKONOMIKE



Drejtori ekzekutiv i Këshillit të Investitorëve Evropianë (KIE), Emrush Ujkani, ka thënë se pa zhvillimin e sektorit privat vështirë se mund të kemi rritje ekonomike në Kosovë. Në intervistën dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se sektori privat duhet të jetë konkurrenues me vendet e rajonit. Ujkani ka treguar se me trendin aktual është e pamundur që Kosova të jetë konkurrenuese me tregjet e rajonit e lëre më gjerë. Sipas tij, shteti ynë ka nevojë për përmirësime të mëtutjeshme në ata sektorë ku Republika e Kosovës ka marrë obligime karshi Marrëveshjes për Stabilizim Asocim (MSA). Ujkani ka thënë se ka nevojë për reforma të ligjeve bazike për të bërit biznes, pastaj për reforma në procedurat administrative të cilat nganjëherë janë të stërzgjatura

KQZ-ja ende nuk ka një datë për shpalljen e rezultateve përfundimtare

Ndonëse po bëhet gati një muaj prej kur janë mbajtur zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 6 tetorit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ende nuk ka një datë për shpalljen e rezultateve përfundimtare. Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se aktualisht nuk mund të shpallen rezultatet përfundimtare për arsye se duhet ta presin përfundimin e të gjitha çështjeve që mund të jenë parashtruar në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) dhe në Gjykatën Supreme



Kosova
përkujton
Anton
Çettën,
ende s'ka
vend për
shtatoren
e tij

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

OPINION

DY HERONJ TË
PANDARË F. 8

Mehmet
HAJRIZI



KOSOVA SI ALGJERIA, JO SI
KRIMEJA E AS SI UKRAINA
LINDORE F. 7

Milazim
KRASNIQI



AKTUALE



IKD-ja: GJYKATAT
PO I ZVARRISIN LËNDËT CIVILE,
QYTETARËT DUHET TË PRESIN
10 DERI NË 15 VJET F. 7

PËRFUNDUAN GARAT E KURANIT
NË NIVEL TË MEDRESEVE TË
BALLKANIT F. 6

EKONOMI

IDEJA E BASHKIMIT TË
DOGANËS DHE ADMINISTRATËS
TATIMORE DREJT DËSHTIMIT F. 9

SHËNOHET ULJE
E TRANSPORTIT
TË MALLRAVE ME TREN F. 9

SPORT

GJILANI NUK I NDAHET
BALLKANIT, DRITA BEFASOHET
NGA FLAMURTARI F. 20

Transicioni i gjatë i FSK-së drejt një force ushtarake

Njohësit e fushës së sigurisë, vlerësojnë se FSK-ja nuk ka bërë ndonjë transformim që mund të vërehet si e arritur e veçantë, kurse përfaqësuesit e institucioneve thonë se me gjithë sfidat e paraqitura punët në drejtim të transformimit kanë ecur sipas parashikimeve

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Forca e Sigurisë së Kosovës po e përmbyll vitin e parë të transicionit drejt shndërrimit në Forcë me kapacitete ushtarake.

Njohësit e fushës së sigurisë, vlerësojnë se FSK-ja nuk ka bërë ndonjë transformim që mund të vërehet si e arritur e veçantë. Kurse përfaqësuesit e institucioneve thonë se me gjithë sfidat e paraqitura, që nga miratimi dhe hyrja në fuqi e tri ligjeve përkatëse, atij për Ministrinë e Mbrojtjes, për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ligjit për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës, punët në drejtim të transformimit kanë ecur sipas parashikimeve.

Burim Ramadani, zëvendësministër në largim i Mbrojtjes, tha për "Radion Evropa e Lirë" se deri tani është arritur që të konsolidohen disa kapacitete për të vazhduar edhe me punët e tjera operationale.

"Në Forcën e Sigurisë së Kosovës është themeluar Shtabi i Përgjithshëm. Janë themeluar katër komandat kryesore. Është rritur numri, është pranuar një numër i pjesëtarëve të rinj dhe si e tillë ka vazhduar puna në aspektet e tjera. Ministria është në përfundim të fazës së transicionit në Ministri të Mbrojtjes dhe në përgjithësi mund të them se tashmë kemi Ministri dhe Forcë në kapacitete edhe administrative, politike dhe operationale që i përgjigjet kërkesave dhe detyrimeve

ligjore", tha Ramadani.

Ramadani tha se Kosova i ka të përcaktuara politikat e saj në rrafshin e mbrojtjes.

"Qeveria ka marrë vendim që edhe Aeroporti i Gjakovës të jetë nën menaxhimin e Ministrisë së Mbrojtjes së FSK-së, në mënyrë që për çfarëdo lloj zhvillimi të kapaciteteve, të kemi edhe hapësirat e nevojshme", tha Ramadani.

Forca e Sigurisë së Kosovës në vazhdimësi është ngritur edhe nën mbikëqyrjen e NATO-s, duke synuar që pas një faze transicioni prej 7-10 vjetësh, edhe Kosova të jetë pjesë e Aleancës Veriatlantike.

Aktualisht, Kosova ka një Qeveri në largim. Kurse Qeveria në ardhje e Kosovës, sipas Ramadani, duhet ta ketë parasysh komponentin e vazhdimësisë së partneritetit ndërkombëtar dhe vazhdimin e politikave strategjike.

"Patjetër ta ruajnë orientimin pro-amerikan, respektivisht modelin amerikan dhe rrjedhimisht modelin e NATO-s në sistemin e armatimit, pajisjeve dhe të komunikimit, kurse elementi i dytë që të vazhdojnë politikat e mbrojtjes dhe besoj edhe programit që ne e kemi paraqitur në strategjinë e sigurisë kombëtare, programin për edukim kombëtar në siguri dhe mbrojtje", tha Ramadani.

Plator Avdiu, njohës i çështjeve të sigurisë nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, thotë se nga punët e bëra deri më tash nuk shihet se



është punuar shumë në këtë drejtim dhe se sipas tij, as në këtë vit dhe as në vitin e ardhshëm, nuk është se mund të pritet shumë në drejtim të një avancimi të punëve për transformim.

"Publikisht mund të duket se janë të ngathët dhe nuk po shohim shumë gjëra konkrete, mirëpo po mendoj që edhe nuk mund të pritet shumë gjatë kësaj faze, përveç ndoshta mund të arrihet pak më tepër në rritjen e numrit të pjesëtarëve, personelit të rekrutëve të ri dhe ndoshta edhe i rritjes së buxhetit nga viti në vit", tha Avdiu.

Avdiu konsideron se institucionet e Kosovës, sikur nuk po nxitojnë t'i kryejnë punët dhe obligimet e tyre me një ritëm

më të shpejtë.

"Mendoj se po merret parasysh edhe ky raporti me NATO-n që gradualisht ndoshta të jetë e pranueshme për shtetet e NATO-s dhe vetë aleancën e NATO-s. Ne anën tjetër edhe vetë plani i transicionit është një plan 10-vjeçar i cili do të marrë kohë derisa FSK-ja t'i arrijë të gjitha kapacitetet defansive për shkak se dihet që kjo do të jetë një forcë kryesisht mbrojtëse, do të thotë defansive dhe nuk do të jetë ofensive", tha Avdiu.

Me planin gjithëpërfshirës të transicionit, planifikohet që numri i pjesëtarëve të FSK-së të arrijë në 5 mijë pjesëtarë aktivë dhe 2 mijë e 500 rezervë. Prej tyre, 10 për qind kërkohet që të jenë nga radhët e komuniteteve

pakicë. Aktualisht, FSK-ja përballlet me problemin e përfshirjes së pjesëtarëve të komunitetit serb, pas presioneve të Beogradit zyrtar, i cili ka ftuar serbët që ta bojkotojnë këtë forcë, duke e konsideruar atë të dëmshme dhe "faktor jostabiliteti në rajon".

Në dhjetor të vitit 2018, Kuvendi i Kosovës miratoi ndryshimet ligjore, për të ndryshuar mandatin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK). Përgjegjësitë e reja të FSK-së kanë të bëjnë me ruajtjen e sovranitetit dhe integritetit territorial, qytetarëve, pronave dhe interesave të Republikës së Kosovës, si dhe mbështetjen ushtarake për autoritetet civile dhe pjesëmarrjen në operationet ndërkombëtare.

Basha sot nis turin

TIJANË, 3 NËNTOR - Lulzim Basha i rikthehet sot (hënë) turit kombëtar të takimeve nëpër rrethe. Elbasani është ndalesa e parë e kryedemokratit nga ku do të zhvillojë dëgjuesen e parë me qytetarët për të vijuar më pas me Korçën, Shkodrën, Vlorën dhe Krujën.

Jashtë zyrës në terren, kryedemokrati pritet t'i dëgjojë nga afër shqetësimet e qyte-

tarëve si dhe të ofrojë alternativën që forca e tij ofron për ndryshimin e situatës.

Turi i takimeve vjen në të njëjtën kohë, kur strukturat kanë marrë porosi për t'u përgatitur për zgjedhje, të cilat opozita jashtëparlamentare kërkon të mbahen të parakohshme parlamentare dhe lokale në një ditë.

Por, jo vetëm baza, por edhe

ekipi politik në qendër po përgatitet për zgjedhje. Juristët e Partisë Demokratike prej ditësh kanë nisur të hedhin ne letër propozimet e tyre për reformën zgjedhore.

Grupet paralele të punës kanë zhvilluar dy takime ndërsa i treti pritet të zhvillohet të martën ku në fokus do të jenë propozimet e anëtarëve për fushatën zgjedhore, ka njoftuar Tch.



KQZ-ja ende nuk ka një datë për shpalljen e rezultateve përfundimtare

Ndonëse po bëhet gati një muaj prej kur janë mbajtur zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 6 tetorit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ende nuk ka një datë për shpalljen e rezultateve përfundimtare. Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se aktualisht nuk mund të shpallen rezultatet përfundimtare për arsye se duhet të presin përfundimin e të gjitha çështjeve që mund të jenë parashtruar në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) dhe në Gjykatën Supreme

dhe Parashtrësia (PZAP) dhe, në rast se ky institucion hedh poshtë ndonjë ankesë, pala e pakënaqur mund të ankohet në Gjykatën Supreme. Ne, gjithashtu, duhet ta presim vendimarrjen e tyre, të veprojmë në përputhje me këto vendime, nëse e obligojnë KQZ-në, në mënyrë që pastaj të mund të procedojmë për certifikimin e rezultateve përfundimtare. Në fund, pasi KQZ-ja merr vendim për certifikimin e rezultateve, e njofton presidentin e Republikës së Kosovës lidhur me rezultatin e këtyre zgjedhjeve", është shprehur Elezi. Më të përfunduar certifikimi i rezultateve përfundimtare fillon edhe faza për krijimin e institucioneve të reja, përkatësisht konstituimi i Kuvendit dhe pastaj formimi i qeverisë. Vonesat për shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 6 tetorit kanë ardhur si rezultat i ankesave të njëpasnjëshme për rinumërimin e mbi 800 vendvo-

timeve. Po ashtu, problem kanë paraqitur edhe votat e ardhura në zarfe nga Serbia, të cilat kanë marrë disa ditë kohë për t'u verifikuar. Fillimisht hapja e tyre ka dhënë pasoja, ku dhjetëra punonjës të Qendrës së Numërimit dhe Rezultatit (QNR) janë helmuar nga kontakti me këto zarfe, të cilët janë trajtuar në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK). Gjithashtu, vonesa kanë krijuar edhe mbi 4 000 vota të ardhura me vonesë nga diaspora për të cilat është dashur të merren dy vendime nga Gjykata Supreme dhe një nga PZAP-i. Ndërkaq sipas rezultateve preliminare të KQZ-së, Lëvizja Vetëvendosje (LV) është fituese e zgjedhjeve të 6 tetorit, kurse në vendin e dytë është renditur Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), e treta ka dalë Partia Demokratike e Kosovës (PDK), e ndjekur nga koalicioni AAK-PSD, kurse koalicioni Nisma-AKR-PD është duke luftuar për ta kaluar pragun zgjedhor.

EPOKA E RE**Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është në pritje të konfirmimit nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia dhe nga Gjykata Supreme se nuk kanë ndonjë çështje për të shqyrtuar apo vendosur në mënyrë që t'i shpallë rezultatet e zgjedhjeve parlamentare të 6 tetorit. Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se vetëm pasi t'i marrin këto konfirmime mund t'i shpallin rezultatet përfundimtare. "Aktualisht Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) nuk mund t'i

shpallë rezultatet përfundimtare sepse duhet ta presim përfundimin e të gjitha çështjeve që mund të jenë parashtruar në institucionet e tjera. Pra, para se të procedojmë me shpalljen e rezultateve përfundimtare, KQZ-ja kërkon konfirmim nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) dhe nga Gjykata Supreme se nuk kanë ndonjë çështje për të shqyrtuar apo vendosur. Vetëm pasi t'i kemi këto konfirmime, KQZ-ja mund të shpallë rezultatet përfundimtare", ka deklaruar Elezi. Më tutje, ai ka treguar procedurat që duhet të ndiqen pas shpalljes së rezultateve përfundimtare në mënyrë që KQZ-ja t'i certifikojë ato. Sipas Elezit, pas shpalljes së rezultateve partitë politike dhe kandidatët e tyre fillimisht mund t'i paraqesin ankesat e tyre në PZAP dhe, në rast se ky institucion i hedh poshtë ato, palët e pakënaqura mund të ankohen në Gjykatën Supreme. Pastaj, pas vendimarrjes së këtyre dy institucioneve, KQZ-ja mund t'i certifikojë rezultatet. "Me shpalljen e rezultateve përfundimtare nuk përmbyllet procesi zgjedhor, pasi subjektet politike dhe kandidatët mund t'i paraqesin ankesat e tyre lidhur me këto rezultate. Fillimisht ankesat mund të paraqiten në Panelin Zgjedhor për Ankesa

dhe Parashtrësia (PZAP) dhe, në rast se ky institucion hedh poshtë ndonjë ankesë, pala e pakënaqur mund të ankohet në Gjykatën Supreme. Ne, gjithashtu, duhet ta presim vendimarrjen e tyre, të veprojmë në përputhje me këto vendime, nëse e obligojnë KQZ-në, në mënyrë që pastaj të mund të procedojmë për certifikimin e rezultateve përfundimtare. Në fund, pasi KQZ-ja merr vendim për certifikimin e rezultateve, e njofton presidentin e Republikës së Kosovës lidhur me rezultatin e këtyre zgjedhjeve", është shprehur Elezi. Më të përfunduar certifikimi i rezultateve përfundimtare fillon edhe faza për krijimin e institucioneve të reja, përkatësisht konstituimi i Kuvendit dhe pastaj formimi i qeverisë. Vonesat për shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 6 tetorit kanë ardhur si rezultat i ankesave të njëpasnjëshme për rinumërimin e mbi 800 vendvo-



Vdes Bojan Stojanović, ish-kryetar i Komunës së Graçanicës

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Ish-kryetari i Komunës së Graçanicës, Bojan Stojanović, ka ndërruar jetë të dielën në moshën 49-vjeçare. Lista Serbe përmes një postimi

në rrjetin social "Facebook" ka theksuar se vdekja e Stojanovićit është humbje e madhe për skenën politike serbe. "Humbje e madhe për familjen Stojanović,

por edhe për skenën politike serbe, është shkuarja e hershme e Bojan Stojanovićit, i cili në vitet e fundit, si anëtar i Listës Serbe, ka dhënë kontributin për

unitetin e serbëve në Kosovë dhe në luftën për jetë më të mirë të qytetarëve tanë", thuhet në reagim të Listës Serbe. Stojanović ishte kryetar i

Komunës së Graçanicës prej vitit 2009 deri në vitin 2013. Së fundi, ai ishte zëvendësministër në Ministrinë e Financave të Qeverisë së Kosovës.



FLET PËR "EPOKËN E RE", EMRUSH UJKANI

Pa zhvillimin e sektorit privat vështirë se mund të ketë rritje ekonomike

Drejtori ekzekutiv i Këshillit të Investitorëve Evropianë (KIE), Emrush Ujkani, ka thënë se pa zhvillimin e sektorit privat vështirë se mund të kemi rritje ekonomike në Kosovë. Në intervistën dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se sektori privat duhet të jetë konkurrues me vendet e rajonit. Ujkani ka treguar se me trendin aktual është e pamundur që Kosova të jetë konkurrenente me tregjet e rajonit e lëre më gjerë. Sipas tij, shteti ynë ka nevojë për përmirësime të mëtutjeshme në ata sektorë ku Republika e Kosovës ka marrë obligime karshi Marrëveshjes për Stabilizim Asocim (MSA). Ujkani ka thënë se ka nevojë për reforma të ligjeve bazike për të bërit biznes, pastaj për reforma në procedurat administrative të cilat nganjëherë janë të stërzgjatura

ka thënë se ka nevojë për reforma të ligjeve bazike për të bërit biznes, pastaj për reforma te procedurat administrative të cilat nganjëherë janë të stërzgjatura.

"Epoka e re": Z. Ujkani, na tregoni çfarë e karakterizoi punën tuaj prej se jeni në krye të Këshillit të Investitorëve Evropianë (KIE) dhe cilat janë objektivat e juaja?

Ujkani: Udhëheqja e Këshillit të Investitorëve Evropianë, para se të them se është privilegj, mendoj se është përgjegjësi e madhe pasi duhet të jemi të kujdesshëm që interesat e tyre, pra të investitorëve evropianë të mbrohen dhe në të njëjtën kohë këto interesa të kapitalizohen duke filluar me mbrojtje nga pengesat që mund të jenë të karakterit legjislativ, administra-

tiv apo edhe politik. Tani objektivi ynë në krye të këtij mekanizmi është që të krijojmë sienergjii të re bashkë me aktorët e tjerë relevantë të sektorit privat që të kemi një platformë të përgjithshme së bashku me asociacionet e tjera e që do të jenë në mbrojtje të interesave të tyre të përgjithshme e më pastaj t'ua dërgojmë institucioneve të Kosovës në një të ardhme të afërt, që përmes kësaj do të jetë një strategji e inkuorporuar e të gjitha asociacioneve një nga një. Këshilli natyrisht se ka një detyrë që t'i mbrojtë interesat e anëtarëve të vet viza-vi të institucioneve shtetërore, pasi duke i promovuar interesat e anëtarëve tanë mendojmë se promovojmë dhe mbrojmë interesin e përgjithshëm të vendit dhe shoqërisë sonë në një kuptim më të përgjithshëm.

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Drejtori ekzekutiv i Këshillit të Investitorëve Evropianë (KIE), Emrush Ujkani, ka bërë me dije se institucioni që drejton ka objektiv të krijojë sienergjii të re bashkë me aktorët e tjerë relevantë të sektorit privat, në

mënyrë që të ndodhë një platformë e përgjithshme së bashku me asociacionet e tjera e cila do të jetë në mbrojtje të interesave të tyre të përgjithshme. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se sektori privat duhet të jetë konkurrues me vendet e rajonit. Ujkani ka treguar se me trendin aktual është e pamundur që Kosova të

jetë konkurrenente me tregjet e rajonit e lëre më gjerë. Ai ka theksuar se pa zhvillimin e sektorit privat vështirë se mund të kemi rritje ekonomike në Kosovë. Sipas Ujkanit, shteti ynë ka nevojë për përmirësime të mëtutjeshme në ata sektorë ku Republika e Kosovës ka marrë obligime karshi Marrëveshjes për Stabilizim Asocim (MSA). Ai



"Epoka e re": Si e vlerësoni ambientin e të bërit biznes në Kosovë?

Ujkani: Kur i referohemi kësaj çështje zakonisht merret për bazë raporti i Bankës Botërore. Të them të drejtën, nuk është një nga raportet që domosdoshmërisht duhet të merret si kriteri kryesor për matjen e ambientit biznesor, pasi përtej asaj çfarë thuhet në këtë raport, ka shumë gjëra të tjera që duhet të shikohen dhe se realiteti është pak më ndryshe. Mendoj se ka nevojë për përmirësime të mëtutjeshme në ata sektorë ku Kosova ka marrë obligime karshi Marrëveshjes për Stabilizim Asocim (MSA) dhe që këto obligime në rend të parë duhet t'i kontribuojnë fuqizimit të konkurrueshmërisë, pasi sektori ynë privat duhet të jetë konkurrues, e që me trendin aktual mendoj se është e pamundur të jemi konkurrentë me tregjet e rajonit, e lëre më gjerë. Mendoj se ka nevojë për reforma të ligjeve bazike për të bërit biznes, pastaj disa procedura administrative të cilat nganjëherë dinë të jenë të stërzgjatura duhet të përmirësohen, respektivisht lehtësohen. S'duhet të harrojmë dy faktorë të rëndësishëm të të bërit biznes. Përveç aspekteve që i përmenda ne, duhet ta kemi një qeverisje që bazohet në ligje, pasi vetëm kështu mund të kemi

një klimë adekuate të të bërit biznes. Po ashtu, duhet të kemi edhe një gjyqësor që duhet t'i adresojë dhe zgjidh në një kohë më optimale lëndët gjyqësore. Rrjedhimisht ne si KIE jemi mbështetës të rithemelimit të Gjykatës Ekonomike. Kur jemi te gjyqësori dhe sundimi i ligjit, mendoj se edhe format alternative të zgjedhjeve të kontesteve duhet të jenë inkurajuese për çfarëdo kontesti që mund të kenë bizneset. Unë flas këtu për anëtarët tanë që jemi për t'i mbrojtur interesat e tyre, por edhe në përgjithësi për interesat e sektorit privat, pasi pa zhvillimin e sektorit privat vështirë se mund të kemi rritje ekonomike.

"Epoka e re": Sa është numri i anëtarëve në Këshillin e Investitorëve Evropianë?

Ujkani: Për momentin kemi një numër të kënaqshëm të anëtarëve marrë parasysh që rregullat statutoare të këshillit parashohin që anëtarët në EIC mund të jenë vetëm ato biznese që kanë kapital nga vendet e Bashkimit Evropian apo vendet evropiane. Një rregull e tillë ndoshta na penalizon për ta rritur numrin e bizneseve që janë anëtare të EIC-së, por që është standard në statut dhe, si i tillë, jam i detyruar ta respektoj në maksimum. Tekefundit, nuk kemi si qëllim final vetëm rritjen e numrit të anëtarëve dhe të kemi shifra kuantitative, por qëllim kemi promovimin dhe mbrojtjen sa më efikase të të drejtave të anëtarëve tanë. Ne kemi kërkesa të reja për anëtarësim dhe jemi në negociata për të pasur se shpejti edhe anëtarë të rinj.

"Epoka e re": Për cilët sektorë është interesimi më i lartë nga anëtarët e KIE-s?

Ujkani: Natyrisht për sektorin financiar, atë të sigurimeve, sektorin e naftës, sektorin e prodhimit dhe shitjes. Këshilli, krahas platformës për mbrojtjen e interesave të anëtarëve të vet që ta ndihmojë sektorin privat në Kosovë dhe t'i vë në kontakt me investitorët evropianë, tani jemi duke punuar dhe jemi në kontakt me Zyrën e Bashkimit Evropian që fillimisht interesat e anëtarëve tanë t'i promovojmë edhe më tej përmes asistencës së Bashkimit Evropian.

"Epoka e re": IPKO-ja është anëtare e KIE-s. Kjo kompani do ta vazhdojë veprimtarinë edhe më tutje në Kosovë?

Ujkani: Të them të drejtën, IPKO është një nga anëtarët tanë me statut të privilegjuar dhe është një prej anëtarëve themelues të KIE-s. Ne jemi në kontakte të rregullta dhe meqë jemi në kohën kur po e ristrukturojmë dhe kemi vendosur disa objektiva strategjike, si KIE ende nuk kemi ardhur në këtë pikë që ta diskutojmë këtë çështje.

Thaçi: BE-ja nuk duhet t'i bëjë gabimet e liderëve të fillimviteve '90

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka filluar një komunikim të ri me opinionin publik, duke publikuar video në llogaritë të tij zyrtare në "Instagram" dhe "Facebook", konkretisht në "InstaStory".

Thaçi një video të cilën e ka publikuar të dielën ka shpalosur bisedat që janë zhvilluar javën e kaluar në takimin e ftuar nga shefja e diplomacisë së Bashkimit Evropian (BE), Federica Mogherini, me liderët e Ballkanit Perëndimor.

Presidenti Thaçi ka thënë se në këtë takim me liderët e Ballkanit Perëndimor janë shprehur të zhgënjyer për mosangazhimin e BE-së në raport me perspektivën evropiane të vendeve të Ballkanit. Në këtë kontekst, Thaçi ka thënë se Kosova është e zhgënjyer me BE-në në raport me mosliberalizimin e vizave. "Gjatë javës që lamë pas liderët e Ballkanit Perëndimor zhvilluam një darkë pune në Bruksel me znj. Mogherini. Të gjithë shprehëm përvojat e punës, në të njëjtën kohë edhe ballafaqimet që i kemi pasur për të ardhmen evropiane të vendeve tona. Ishte konkludim i përbashkët i liderëve të Ballkanit Perëndimor, një zhgënjim masiv mund të themi, për mosangazhimin konkret të



Bashkimit Evropian për shtetet e Ballkanit Perëndimor. Një zhgënjim ky që përcillet edhe në Kosovë, në veçanti me joliberalizimin e vizave për Kosovën, kur ne i kemi plotësuar të gjitha kriteret. Kjo po ndodh për shkak të mungesës së unitetit evropian dhe jo që Kosova nuk i ka zbatuar të gjitha kriteret. Por, ne kemi vetëm një të ardhme, atë evropiane", ka thënë Thaçi. Ai ka thënë se BE-ja nuk guxon t'i përsërisë gabimet e liderëve të viteve të '90 në kohën e krizës jugosllave. "Prandaj, Bashkimi

Evropian dhe liderët e saj, në këtë kohë të mungesës së vizionit të tyre, duhet të dëshmojnë se nuk do t'i bëjnë gabimet e liderëve të fillimviteve të '90 të BE-së, në kohën e fillimit të krizës jugosllave. Sepse gjithmonë në Ballkanin Perëndimor ka potenciale të rrezikshme për paqen, sigurinë dhe stabilitetin. Ne duam të besojmë se BE-ja do të fillojë të ndryshojë pozitivisht për Kosovën dhe për tërë Ballkanin Perëndimor", është shprehur Thaçi.

Sejdiu kërkon përgjegjësi konkrete në LDK për humbjen e zgjedhjeve të 6 tetorit

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Mosradhitja e LDK-së si parti e parë në zgjedhjet e 6 tetorit duhet të përcillet me përgjegjësi konkrete. Nuk duhet të shkohet në vazhdimësi duke humbur zgjedhjet dhe mos të ketë reflektim karshi tyre. Zgjedhjet kanë qenë të rregullta me një ecje pak më pozitive se proceset e hershme. Kështu ka thënë në një intervistë për "Kosovapress", ish-presidenti i Kosovës dhe ish-kryetari i LDK-së, Fatmir Sejdiu. Ai ka thënë se duhet të bëhet një analizë e mirëfilltë nga LDK-ja për t'i shikuar premtimet që janë bërë dhe realizimin e tyre. Ai ka thënë se një koalicion në mes të Lëvizjes Vetëvendosje dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës duhet të formohet mbi interesin e Kosovës dhe qytetarëve. Në lidhje me procesin zgjedhor



të këtij viti, Sejdiu ka thënë se ka qenë më korrekt se herët të tjera. Në zgjedhjet e 6 tetorit Lëvizja Vetëvendosje, sipas rezultateve preliminare të KQZ-së, radhitet e

para, e pasuar nga LDK-ja. Ndërkaq, kjo e fundit prej zgjedhjeve parlamentare të vitit 2004 nuk ka mundur të fitojë asnjë proces zgjedhor.

Kosova përkujton Anton Çettën, ende s'ka lokacion për shtatoren e tij

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Të dielën janë bërë 24 vjet nga vdekja e Anton Çettës. Ai mbahet mend për urtësinë e tij që kishte dhe për punën e madhe që ka bërë në mbledhjen e folklorit shqiptar. Në vitet më të rënda të dekadës së fundit të shekullit që shkoi, Anton Çetta ka dhënë kontribut të gjerë humanitar dhe kombëtar, duke pajtuar mijëra raste të gjakmarrjes. Por veprimtaria e tij më e madhe ishte në lëvizjen e pajtimit të gjaqeve. Kjo lëvizje u zhvillua në fillim të viteve '90 dhe arriti për një kohë të shkurtër ta shuante pjesën më të madhe të hasmërive mes shqiptarëve në Kosovë dhe trevat e tjera shqiptare.

Kjo lëvizje e udhëhequr nga plaku i urtë u përkrah nga studentët dhe intelektualët e

kohës. Me rastin e 24-vjetorit të vdekjes së Anton Çettës, presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka përkujtuar Çettën, duke thënë se ai ka hyrë në historinë e re të Kosovës si pajtues i gjaqeve dhe mbledhës i thesarit të çmuar të trashëgimisë sonë folklorike. "Në vitet më të rënda të dekadës së fundit të shekullit që shkoi, Anton Çetta dha kontribut të gjerë humanitar dhe kombëtar, duke pajtuar mijëra raste të gjakmarrjes. Më pas, Kosova shkoi drejt çlirimtare me një plagë socialpsikologjike më pak, falënderuar urtësisë së këtij burri dhe dhjetëra aktivistëve të tjerë që e shoqëruan atë anembanë Kosovës", ka shkruar presidenti Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, ka përkujtuar atdhetarin Anton Çetta, në 24-vjetorin e vdekjes. Haradinaj ka thënë se Anton Çetta nëpërmjet

aksionit për pajtimin e gjaqeve ka unifikuar lëvizjen kombëtare për liri dhe pavarësi. "Iluministi atdhetar, Anton Çetta, përmes bashkimit e pajtimit të popullit shqiptar ia doli që me lëvizjen e tij ta shkëpusë shoqërinë tonë nga epoka e gjakmarrjes për ta unifikuar në lëvizjen për liri dhe pavarësi. Kujtimi për unifikuesin shqiptar, pajtimtarin e mijëra gjaqeve dhe humanistin e madh, nuk është zbehur as pas 24 vjetësh nga vdekja e tij. Angazhimi i tij me peshë historike do të jetë frymëzues për brezat", ka shkruar ai në llogarinë e vet në "Facebook".

Ndërsa filozofi Blerim Latifi ka thënë se Anton Çetta gjithë jetën ia kushtoi kulturës popullore të vendit të tij, duke e nxjerr atë nga mesjeta përmes pajtimit të gjaqeve. Sipas tij, është e papranueshme që ende nuk ka pajtim për vendosjen e shta-



tores së Çettës në Prishtinë. "Gjithë jetën ia kushtoj kulturës popullore të vendit të tij. Në pleqëri bëri më të mirën që një intelektual mund të bëjë për atdheun e vet: e nxori nga mesjeta, përmes pajtimit të gjaqeve. Ai na mësoi kulturën e pajtimit, e ne sot nuk pajtohemi dot për ta vënë një shtatore të tij, diku në Prishtinë! Sepse, ne sot jetojmë

me kulturën e mosmirënjohjes", ka shkruar Latifi në llogarinë e vet në "Facebook". Po ashtu, ditë më parë për mosvendosjen e shtatores së Anton Çettës ka reaguar edhe ambasadorja e Kosovës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA), Vlora Çitaku. "Turpi qoftë mbi ne", pati shkruar Çitaku në llogarinë e vet në "Facebook".

Përfunduan garat e Kuranit në nivel të medreseve të Ballkanit

PRISHTINË, 3 NËNTOR (ER) - Garat e Kuranit në nivel të medreseve të Ballkanit, të cilat u mbajtën nën përkujdesjen e kryetarit të Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, Myftiut Naim Tërnavë, dhe të organizuara nga Medreseja e Mesme "Alauddin", kanë përfunduar të dielën. Në këtë eveniment përmblyës, pas Myftiut Naim ef. Tërnavë, me bashkëpunëtorë, morën pjesë kryetarë të kështillave të BI-së, përfaqësuesi i Dijanetit nga Turqia, Arabia Saudite, Shqipëria, Sanxhaku, Mali i Zi, Kroacia, Bullgaria, Bosnja dhe shumë mysafirë të tjerë.

Në këto gara morën pjesë nxënës dhe nxënës të medreseve të Ballkanit nga Kosova, Shqipëria, Turqia, Bosnja, Mali i Zi, Kroacia, Bullgaria dhe Sanxhaku, ku patën rastin ta shfaqin talentin dhe performancën e tyre në leximin-këndimin e Kuranit. Kjo është gara e dytë që u organizua në nivel ballkanik dhe të gjithë pjesëmarrësit falënderuan BIRK-un, Myftiun Tërnavë dhe Medresenë si nikoqire për këtë organizim.

Në përmblyllje të kësaj gare mori fjalën Myftiu Tërnavë duke falënderuar të gjithë pjesëmarrësit në këtë garë dhe jurinë tejet profesionale të këtyre garave. Ai ka theksuar se ishte një garë e fortë dhe nuk ka asnjë humbës. Tërnavë është shprehur i mahnitur me paraqitjen dhe leximin e këtyre nxënësve, të cilët janë argument i qartë se islami në këto troje është i fortë dhe i qëndrueshëm dhe që, sipas tij, myslimanët kanë identitet me të cilin krenohen. Ai, po ashtu, ka falënderuar Abdullah Garin, drejtor i Zyrës Rajonale të



Organizatës së Ligës së Botës Islame (Rabita) dhe drejtorin gjeneral të Ligës së Botës Islame, Muhamed Alisa, për ndihmën e ofruar për mbajtjen e këtyre garave.

Tërnavë ka falënderuar edhe drejtorin e Medresesë, Jakup Çunaku dhe stafin e tij për këtë organizim shumë të mirë të garave kuranore. "Ky nivel i garave do të vazhdojë, por unë bashkë me kolegët e mi bashkërisht do ta shqyrtojmë mundësinë që të organizojmë gara të nivelit evropian dhe të atij botëror. Kosova do të jetë një vend ku do të përkundet Kurani, rritet dhe në këto gara do të marrin pjesë lexuesit më të mirë nga bota ku do të garohet për fjalën e Zotit, dhe kjo më jep fuqi që me tërë potencialin tim që kam ta sigurojmë mundësinë që bashkërisht t'ia dalim", është shprehur Tërnavë.

Drejtori i Medresesë "Alauddin", Jakup Çunaku, në fjalën e tij përmblylëse ka falënderuar pjesëmarrësit në këtë garë si dhe ka falënderuar edhe shkollat të cilat

kanë dërguar nxënës në garën uranore, duke theksuar porosinë kuranore "bashkëpunoni në punë të mira dhe të mbara".

Edhe ky organizim i sivjetmë, që llogaritet i dyti i këtij niveli në historinë e Medresesë "Alauddin", është në vazhden e bashkëpunimit të mirë e të ndërsjellë ndërmjet medreseve të mesme të Ballkanit.

Çunaku ka falënderuar anëtarët e komisionit vlerësues, të cilët bënë një punë shumë të mirë dhe kryen me përpikëri këtë përgjegjësi.

"Vlerësoj se këto gara ishin të suksesshme vetëm për faktin se jemi tubuar për herë të dytë me tetë medrese të ndryshme nga Ballkani dhe ky tubim ka peshë dhe rëndësinë e vet ku jemi njohur edhe më shumë me njëri-tjetrin", ka deklaruar Çunaku.

Në këto gara morën pjesë gjithsej 40 garues nga tetë vende të Ballkanit, të cilët testuan memorizimin dhe leximin e bukur të tyre, përballë një komisioni profesional në përbërje të: Hfz. Safet Hoxha (Kosovë), Hfz. Etem Alanka (Turqi), Abdullah Al-Muhib (Siri), Hfz. Aziz Alili (Kroaci) dhe Dr. Emjed Saadeh (Jordani).

Fituesit e tri vendeve të para në nivelin e garës për lexim të lirë të meshkujve janë: 1. Ahmed Shadinlija (Bosnjë), 2. Mahmud Enes Alpsumer (Turqi) dhe 3. Miraxh Islami (Kosovë).

Ndërsa fituesit e tri vendeve të para në nivelin e garës për lexim të lirë të femrave janë sipas kësaj radhitjeje: 1. Rejhana Ukperaj (Shqipëri) dhe 2. Firesa Gollaku (Kosovë).

Në garën për hifz të xhuzit të 30 në kategorinë meshkuj fituan: 1.

Muhamet Vehap (Bosnjë), 2. Eronit Hajdari (Kosovë) dhe 3. Amin Sula (Shqipëri).

Ndërsa për femra në këtë kategori fituese janë: 1. Nexhla Zukorliç (Sanxhak), 2. Rejhane Murati (Kosovë) dhe 3. Naida Doiç (Kroaci).

Në garën për tri xhuza në kategorinë meshkuj fituan: 1. Lind Gralleva (Kosovë),

2. Abdurrahman Abdulmenan (Bosnjë) dhe 3. Alen Bala (Shqipëri).

Ndërsa për femra në këtë kategori fituese janë: 1. Anisa Dërguti (Kosovë), 2. Sumeja Destanoviç (Sanxhak) dhe 3. Rejhana Ukperaj (Shqipëri).

Në garën për hifz (memorizimit të Kuranit) në 5 xhuza në kategorinë meshkuj fitues janë: 1. Bilal Hamidoviç (Bosnjë), 2. Ubejd Ademi (Kosovë) dhe 3. Mustafa Khan Agirbash (Turqi).

Ndërsa për femra në këtë kategori fituese janë: 1. Amire Dërguti (Kosovë) dhe 2. Emina Zukorliç (Sanxhak).

Po ashtu, duhet theksuar se të gjithë drejtorët e medreseve ballkanike pjesëmarrëse në këtë garë falënderuan myftiun Tërnavë për këtë organizim kaq madhështor e të suksesshëm që u vlerësua nga ta se vërtetë nuk dallonte nga organizimet e rangjeve botërore të garave kuranore.

Në fund iu dhanë mirënjohje dhe fletëfalënderime për përfaqësuesin e Ligës Botërore Islame, të medreseve pjesëmarrëse, anëtarëve të komisionit vlerësues, si dhe shpërblimet fituesve të këtyre garave. Krejt në fund për pjesëmarrësit e kësaj gare u organizua një vizitë nëpër Kosovë.



KOSOVA SI ALGJERIA, JO SI KRIMEJA E AS SI UKRAINA LINDORE



Milazim KRASNIQI

Aneksimi i Krimesë nga Rusia nxori në qarkullim edhe një krahasim të ri absurd të Kosovës me një vatër krize si pasojë e agresionit imperial rus, me atë të Krimesë, po edhe të Ukrainës Lindore. Këtë krahasim fillimisht e lansoi vetë presidenti rus Vladimir Putini. Ndërsa ambasadori i tij në Tiranë, Leonid Abramovi, e ka krahasuar intervenimin e armatës së Ukrainës në lindje të vendit ndaj popullsisë rusofone, si të ngjashëm me intervenimin e armatës serbe në Kosovë! Rusët po aneksojnë, po shkaktojnë çrregullime në Ukrainë dhe pastaj po luajnë majtap, duke përmendur emrin e Kosovës!

Përveç kalkulimeve diplomatike që bëjnë rusët, kjo ka të bëjë me një defekt të madh lidhur me Kosovën: nuk është qartësuar ende sa duhet rruga e ndërimit të shtetit të Kosovës. Ky është një problem serioz për shtetin tonë.

E keqja është se edhe para këtij krahasimi që bëjnë rusët me vatrat e krizave që i shkaktojnë vetë në truallin e Ukrainës, Kosova është krahasuar me lloj-lloj krizash e vendesh edhe nga aleatët e saj. Krahasime absurde janë bërë me Tirolin, me Kataloninë me dy Gjermanitë etj. Kjo përzjerje e elementeve të krizave, duke bërë përpjekje që prej tyre të shpjegohet lufta çlirimtare e Kosovës dhe rruga e shtetndërtimit të saj, e ka rritur konfuzionin ndaj saj dhe prej këndeje edhe bllokimin e pranimin të saj si shtet prej shumë shteteve të botës dhe organizatave ndërkombëtare.

Megjithatë, mbetet e ngritur pyetja: a ka qenë e ngjashme me ndonjë krizë tjetër kriza e Kosovës dhe rruga e saj e shtetndërtimit? Mua më duket se po. Kosova mund të krahasohet më së miri me Algjerinë, në përpjekjet e saj për çlirim e pavarësi. Shikojini ngjashmëritë: Franca e pati aneksuar Algjerinë dhe e pati shpallur pjesë të shtetit francez, (1848) edhe pse algjerianët nuk ishin me asgjë francezë. Ashtu pati bërë edhe Serbia me Kosovën (1912.) Serbia pushtoi tokën e shqiptarëve, të cilët ishin një popull krejt tjetër me gjuhë, me kulturë, me fe e me gjithçka, ashtu sikur ishin të ndryshëm edhe algjerianët në raport me francezët. Franca pati imponuar një regjim segregues e diskriminues në Algjeri, ashtu që liritë dhe të drejtat e kolonistëve francezë nuk vlenin për "qytetarët francezë" që ishin etnikisht

algjerianë. Njësoj pati bërë Serbia me shqiptarët në Kosovë. Pati sjellë kolonistë dhe u pati dhënë statusin e qytetarëve të rendit të parë, duke u dhënë privilegje të mëdha. Për të mbrojtur privilegjet e tyre, Serbia (dhe Jugosllavia) me ligj pati ndaluar madje edhe shitblerjet ndërmjet shqiptarëve e serbëve. Pas fillimit të rezistencës guerile dhe asaj të armatosur algjeriane, Franca përdori Armatën në taktikat e saj të terrorit ndaj popullit algjerian. Njësoj ka bërë edhe Serbia në Kosovë, duke përdorur armatën në ushtrimin e terrorit, të vrasjeve në masë të civilëve, të dje-gies së vendbanimeve shqiptare dhe të spastrimit etnik. Franca pati armatosur edhe kolonistët e kolaboracionistët. Njësoj pati bërë edhe Serbia, veçmas në vitet nëntëdhjetë në Kosovë. Franca pati përdorur edhe Legjionin e të Huajve për terror e masakra ndaj popullsisë civile. Të njëjtat taktika terrori ka përdorur Serbia në vitet 1998/1999 me formacionet paramilitare, që kanë qenë të ngarkuara për të ushtruar terror e masakra ndaj popullsisë civile.

Dallimi i vetëm në këtë mes është se qytetarët francezë, iu kundërvunë politikës së terrorit e të gjenocidit të shteti të vet, kur e kuptuan dhe u deklaruan me plebishit për largimin e shtetit francez nga toka algjeriane. Dhe nga ai disponim u prodhua edhe politika e De Golit, që e pranoi realitetin me marrëveshjen e vitit 1962. Ndërsa qytetarët e Serbisë, edhe pse e kuptuan të vërtetën, masivisht u solidarizuan me politikën e shtetit të vet kundër shqiptarëve të Kosovës. Rrjedhimisht, në Serbi nuk mund të lindte një De Gol serb. Prandaj u desh intervenimi i NATO-s për ndaljen e gjenocidit të saj ndaj shqiptarëve dhe largimin e saj nga Kosova. Por, Serbia e Rusia nuk e pranojnë këtë realitet. Prandaj i luajnë letrat si t'u vjen për mbarë, duke e instrumentalizuar tregimin për Kosovën në projektet e tyre imperiale e pansllaviste.

Prandaj, politika shqiptare e Kosovës dhe politika shqiptare në përgjithësi, duhet të ndërtojë sa më shpejt një narracion të vetin lidhur me Kosovën, historinë e saj të aneksimit nga Serbia, të luftës për pavarësi dhe të çlirimit të saj. Kjo do të pengonte propaganduesit militarë rusë që të mos e përdorin në mënyrë kaq abuzive Kosovën, sa herë duan të arsyetojnë politikën e tyre të agresionit, duke i maskuar pas një shembulli krejtësisht joadekuat. Ata këtë e bëjnë për të përfitur vetë e njëherësh për ta dëmtuar Kosovën.

(P. s. Për këta pesë vjet nuk ka reflektuar asnjë politikan i këtij vilajeti të vetëhumbur.)

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka publikuar raportin "Drejtësia civile në Kosovë, ligji vs praktika"

IKD-ja: Gjykatat po i zvarrisin lëndët civile, qytetarët duhet të presin 10 deri në 15 vjet

Gjykatat në Kosovë vazhdojnë t'i zvarrisin lëndët civile, me ç'rast qytetarëve u duhet të presin 10 deri në 15 vjet për ta realizuar të drejtën e tyre. Kështu është thënë në raportin "Drejtësia civile në Kosovë, ligji vs praktika" të realizuar nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD). Sipas të gjeturave të këtij raporti, ka drejtësi selektive meqë nuk trajtohen njëjtë qytetarët e thjeshtë dhe ata që vijnë nga politika. IKD-ja ka bërë thirrje që lëndët civile të kryhen brenda një afati të arsyeshëm kohor



Faton DERMAKU

PRISHTINE, 3 NËNTOR - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) të dielën në një konferencë për medie ka publikuar raportin "Drejtësia civile në Kosovë, ligji vs praktika". Gjatë prezantimit të këtij raporti, drejtori i IKD-së, Ehat Miftaraj, ka treguar se janë monitoruar 2 000 seanca gjyqësore dhe, bazuar në të gjeturat, ka zvarritje të lëndëve civile, me ç'rast qytetarët duhet të presin 10 deri në 15 vjet. Ai ka thënë se ka drejtësi selektive meqë nuk trajtohen njëjtë qytetarët e thjeshtë dhe ata që vijnë nga politika. "Raporti ka të bëjë me monitorimin e 2 000 seancave gjyqësore. Ka zvarritje të rasteve nga ana e gjykatave. Qytetarët e Kosovës për ta realizuar një të drejtë duhet të presin ndoshta deri në 10-15 vjet për ta marrë drejtësinë nga gjykatat tona. Karakteristikë tjetër e këtij raporti është drejtësia selektive, nuk trajtohen njëjtë qytetarët e thjeshtë për dallim nga ata që vijnë nga politika", ka deklaruar Miftaraj. Po ashtu, ai ka thënë se në Gjykatat e Kosovës është duke u luajtur loja e ping-pongut pasi që lëndët kthehen në rigjykim. "Loja pingpong po bëhet në Gjykatën e Apelit që vazhdon t'i rikthejë në rigjykim lëndët që janë kthyer në Gjykatën Themelore. Raporti gjen se gjykatësit, pavarësisht rolit administrues, asnjëherë nuk mund ta arrijnë trajtimin e lëndëve në kohë", ka deklaruar Miftaraj. Ndërkohë hulumtuesi në IKD, Gëzim Shala, ka bërë me dije se nga viti në vit është duke u rritur numri i lëndëve të pazgjidhura. Sipas tij, nevojiten mbi dy dekada për t'u zgjidhur lëndët e mbetura. "Gjyqtarët kanë kryer nga 182 lëndë, përkatësisht nga 147 lëndë më pak. Nga viti në vit është rritur numri i lëndëve të pazgjidhura. KGJK-ja ka bërë një hap deskriptiv sa i përket trans-

parencës, mes gjyqtarëve ka një disbalancë të madhe në lidhje me lëndët e kryera. Në vitin 2019 sistemi gjyqësor i ka kryer 166 lëndë më shumë sesa ka pranuar, KGJK-së i duhen 22 vjet për t'i zgjidhur lëndët. Sikur të zbatohet norma, lëndët e pazgjidhura të cilat barten nga viti në vit do të përfundonin për pak më shumë se dy vjet dhe sistemi gjyqësor do ta arrinte stabilitetin në kuptimin e ngarkesës së gjyqësorit me lëndë civile", është shprehur Shala. Ai ka theksuar se emërimi i nëntë gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit ka ndikuar në uljen e numrit të lëndëve të pazgjidhura. "Në Gjykatën e Apelit në vitin 2019 janë emëruar edhe 9 gjyqtarë të rinj dhe kjo ka ndikuar pozitivisht në uljen e numrit të lëndëve të pazgjidhura të cilat barten vit pas viti. Gjykata e Apelit tani ka hyrë në binarët drejt stabilizimit të numrit të lëndëve. Sipas KGJK-së, kohëzgjatja e trajtimit të një rasti nga parashtrimi i padisë deri në aktgjykim përfundimtar është 1 732 ditë. Pasoja e vonësive në trajtimin e rasteve civile është humbja e besimit të publikut në sistemin gjyqësor si dhe nxitja e qytetarëve për ta marrë drejtësinë në duar", ka thënë Shala.

Edhe hulumtuesja tjetër në IKD, Shqiponjë Gashi, ka thënë se zvarritja e lëndëve në dekada cenon të drejtat dhe liritë e qytetarëve. Ajo ka thënë se KGJK-ja duhet të bëjë një analizë gjithëpërfshirëse të divizioneve të gjykatave si dhe ta ngritë llogaridhënien e gjykatësve. "KGJK duhet të kuptojë se zvarritja e lëndëve me dekada cenon rëndë të drejtat dhe liritë e qytetarëve për të pasur një proces gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm kohor. Zvarritja e trajtimit të lëndëve nëpër gjykata e humbet besimin e publikut në sistemin e tyre, andaj duhet të ndërmarrë masa urgjente për shmangien e situatave të tilla", ka deklaruar Gashi.

DY HERONJ TË PANDARË



Mehmet HAJRIZI

Lëvizja Kombëtare Shqiptare e filimit të dekadës së nëntë të shekullit të kaluar, pas pagëzimit të zjarrit me kryengritjen e vitit 1981, pati humbje të rënda, por radhët e saj u ripërtërinë nëpër flakët e pushkëve, në shtettrëthim e nëpër barrikada, duke formuar e kalitur veprimtarë të shquar profesionistë, si Fahri Fazliu dhe Afrim Zhitia.

Djem të Llapit kryengritës, këta dy dëshmorë të ardhshëm, vinin nga familje të shquara atdhetare në radhët e organizuara.

Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu që në moshë të re, si shkollarë të mesëm aderuan në lëvizje dhe hynë në radhët e para të kryengritjes së vitit 1981. Ata me sytë e tyre e panë aty fuqinë prej uragani të popullit të zgjuar nga letargjia e robit dhe potencialin kolosal të lirisë.

Vetëm një vit pas kryengritjes, Lëvizja Kombëtare arriti të bashkonte forcat në një front të vetëm, Lëvizja për Republikën Shqiptare në Jugosllavi, e cila e vazhdoi veprimtarinë, si LPRK dhe më vonë LPK. Afrim Zhitia që në vitin 1980 vepronte në OMLK, për të qenë pastaj bashkë me Fahri Fazliun në LPRK. Përveç kësaj lëvizjeje, në Kosovë vepronin edhe shumë organizata të tjera, si vazhdimësi e organizimit më të hershëm, ose si themelime të reja. Lëvizja Kombëtare e këtij dhjetëvjetëshi kishte si mjet veprimi edhe një shtyp klandestin të admirueshëm, me të cilin komunikonte me publikun, përhapë idetë e lirisë, demaskonte politikën e regjimit pushtues dhe informonte objektivisht qytetarët. Afrim Zhitinë më 1984 e arrestuan, për ta dënuar në moshë të njomë me tetë vjet burg. Më 1988 kthehet në Kosovë, ku i gjeti shokët e tij në krye të detyrës. Fahri Fazliu që ishte shumë aktiv në këtë periudhë vuri kontakt me Afrimin, ngjashëm siç ishin lidhur heronjtë Rexhep Malaj e Nuhi Berisha, më 1983.

Gjatë viteve 1988-1989 veprimtarët më të dalluar në Kosovë që praktikisht e morën drejtimin e LPRK-së ishin: Fadil Vata, Afrim Zhitia, Fahri Fazliu, Ahmet Haxhiu, Ali Ajeti, Bedri Sokoli etj. Fahri Fazliu, ose Fatmiri, siç e quanin zakonisht, shquhej më shumë për organizim dhe veprimtari praktike, duke shtrirë radhët e organizuara gjithandëj trevave të pushtuara shqiptare. Ai nuk shkruante shumë, siç bënte Afrimi, por janë të njohura tri pikëpamje të tij për çlirimin e

Kosovës. Në përputhje me zhvillimet demokratizuese në rajon, ai paraqiste strategjinë e tij në dy shtylla: Ndërkombëtarizimin e çështjes shqiptare dhe zgjidhjen eventuale të saj në rrugë paqësore, nëpërmjet të një referendumi, në të cilin do të deklarohet vullneti i shqiptarëve për të jetuar të lirë dhe të pavarur. Por, në rast se nuk do të arrihej çlirimi me mjete paqësore, ai kishte pikëpamjen e tretë të zgjidhjes së njëjës, me kryengritje të armatosur.

Fundi i viteve tetëdhjetë e kishte acaruar gjendjen, jo vetëm në Kosovë, por në gjithë rajonin. Kampi socialist po shembej si gurët e dominosë. Rajoni karakterizohej nga lufta për çlirim nga ideologjia komuniste dhe totalitarizmi, por popujt me të drejtat e mohuara kombëtare, përpjekjet i drejtonin më parë për pavarësinë kombëtare, shtetin nacional dhe sovranitetin.

Duke shpallur luftën ekspansioniste më 1989, diktatori serb Milosheviq i dha erë baroti gjithë Federatës jugosllave, e cila u shemb në pellgun e gjakut të popujve të saj.

Transformimet demokratike në rajon, nuk patën asnjë efekt pozitiv për të drejtat e shqiptarëve nën Jugosllavi, sepse regjimi kriminal serb, u vërsul me të gjitha mjetet për ta suprimuar edhe atë autonomi që e kishte Kosova dhe vendosi aty masa të dhunshme në çdo fushë të jetës.

Afrim Zhitia me penën e tij të mprehtë, do të shkruajë: "Dhe në fund mendojmë dhe jemi të bindur se reaksioni serbomadh nuk ka ku të shkojë më tej nga hapja e zjarrit kundër masave popullore shqiptare lirishtë. Lufta jonë e drejtë nacional-çlir-

imtare ka ku të shkojë më tej-drejt fitores..." Në një tjetër shkrim ai, duke analizuar demonstratat e nëntorit të vitit 1988, i parashikon në mënyrë profetike zhvillimet e ardhshme: "Kosova ka hyrë tashmë në një lëvizje të re e vendimtare për fatin e vet, zhvillimet e së cilës nuk do të ndalen dot derisa të mos arrihet liria".

Diskutimi farsë publik i ndryshimeve kushtetuese të vitit 1989 për rrënimin e autonomisë së Kosovës, u kundërshtua fuqishëm nga lëvizja dhe qytetarët. Do përmendur në mënyrë të veçantë protestën e mbi 1.300 minatorëve të Trepçës, thellë në horizontet e minierës, që patën solidaritet të gjerë brenda e jashtë dhe sidomos te studentët, bashkë me të cilët në grevë ishin edhe Fahriu e Afrimi. Regjimi ndërkaq, ndërmoi masa të përgjakshme për ta shuar revoltën e qytetarëve, duke krijuar kushtet që më 23 mars 1989, ta suprimonte autonominë e Kosovës. Afrim Zhitia do të shkruajë: "Shtypja kombëtare, shovinizmi e histeria nacionaliste kurrë nuk e kanë treguar egërsinë e tyre kaq lakurike sa... gjatë muajve shkurt-maj 1989. Pamjet rrëqethëse tregonin se kërbaci policor, tanket dhe ushtria siguruan aprovimin e amendamenteve të Kushtetutës së Serbisë, prandaj populli sot me të drejtë Kushtetutën e 're' e quan 'Kushtetutë e tankeve', anti-shqiptare e antinjerëzore".

Për mbrojtjen e Kosovës një popull i tërë u ngrit në këmbë, i udhëhequr nga bijat dhe bijtë më të mirë, siç ishin Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu. Në ditën e heqjes së autonomisë, në demonstratë regjimi vrau 29 shqiptarë dhe deri në fund të prillit numri i të vrarëve

arriti në 100.

Duke u përgatitur për rezistencën e armatosur, Afrim Zhitia, Fahri Fazliu dhe bashkëveprimtarët e tyre të shquar, Ali Ajeti, Fadil Vata etj., ishin pararendësit e Ushtrisë Çlirimtare.

Më 31 tetor dhe 1 e 2 nëntor të vitit 1989, demonstratat në Kosovë kishin arritur përmasa dramatike. Më 1 nëntor vritet Bedri Sokoli, veprimtar syapatrembur dhe militant i përgatitur, kurse shumë të tjerë u plagosën rëndë. Afrim Zhitia mban një fjalim të zjarrtë në demonstratë, me të cilin i drejtohej masës prej 12.000 vetave.

Më 2 nëntor 1989, në Kodrën e Diellit në Prishtinë, rrethohen nga forcat serbe veprimtarët, organizatorët dhe drejtuesit e LPRK-së, Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu, të cilët pas rezistencës plot dhjetë orë kundër qindra forcave kriminale të regjimit, bien heroikisht në altarin e lirisë.

Rënia e Fahriut, Afrimit, Aliut e Bedriut, vdekja e hershme e Fadil Vatës, vrasja e Xhemajli Berishës etj., ishin goditje tepër e rëndë për LPRK-në dhe Lëvizjen Kombëtare në përgjithësi, por Kosova i përballoi sfidat dhe e mbajti kursin e saj drejt fitores përfundimtare.

Virtytet e tyre sublime njerëzore e atdhetare, politike e morale, u bënë pjesë e rëndësishme e sistemit të vlerave që kultivoi Lëvizja Kombëtare. Të këtij sistemi vlerash të trashëguara janë edhe një varg shkrimesh të Afrim Zhitisë, në të cilat trajton çështje të ndryshme të jetës shqiptare nën robëri. Ato janë bërë me kompetencë shkencore dhe politike, të denja për një intelektual të përgatitur mirë për punën profesionale.

Veprimtarë të hershëm dhe me

përvojë të gjatë, Afrimi dhe Fahriu lidhën breza të Lëvizjes Kombëtare, sidomos të dy periudhave të lavdishme të rezistencës, asaj 1981 dhe 1989. E para ishte përgatitur nga Lëvizja Kombëtare Shqiptare e viteve shtatëdhjetë, kurse e dyta gjatë viteve të rimëkëmbjes së saj, pas vitit 1981. Por, para së gjithash, Fahriu dhe Afrimi ishin lidhur fort shpirtërisht njëri me tjetrin. Në vështrim të kronikës së të rënëve të lëvizjes sonë më të re kombëtare, gjejmë shumë shembuj të lidhjeve të forta binjakëzuese midis tandemëve veprimtarë që nuk bënin njëri pa tjetrin, që e përplotësonin njëri-tjetrin dhe që nuk mund t'i ndante jeta, as sakrificat supreme. Këtë lidhje sublime dhe këtë shembull epik, dy heronjtë tanë e kurorëzuan madhërisht në Epopenë e Kodrës së Diellit.

Pas rënies së dy heronjve, dikush mbi varrin e Afrim Zhitisë la nja letër pusullë në të cilën shkruante: "Bie një, ngrihen njëmijë". Ky ishte efekti i çdo humbjeje të luftëtarëve të lirisë, ky ishte shpjegimi me një fjalë i fenomenit të ringjalljes si Feniksi të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe vetë dialektika e zhvillimit të saj.

Oshtima e armëve të Nuhi Berishës dhe Rexhep Malajt në Kodrën e Trimave më 1984 dhe e Afrim Zhitisë e Fahri Fazliut më 1989 në Kodrën e Diellit, paralajmëronin, në jug e në veri, vitin e afërt të oshtimës së armëve të UÇK-së në Kosovë.

I përjetshëm qoftë kujtimi për dëshmorët e kombit!

(Fjalë e mbajtur në 30-vjetorin e rënies së Afrim Zhitisë dhe Fahri Fazliut, më 2 nëntor 2019)



Ideja e bashkimit të Doganës dhe Administratës Tatimore drejt dështimit

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Projektionet për bashkimin e Administratës Tatimore dhe Doganës në Agjencinë e të Hyrave të Kosovës po shkojnë drejt dështimit.

Autoritetet qeveritare në Kosovë në vitin 2016 kishin miratuar bashkimin formal të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) dhe Doganës së Kosovës (DK) në një agjenci të përbashkët, duke e quajtur atë si Agjencia e të Hyrave të Kosovës. Për këtë qëllim para tre vjetësh ishte harmonizuar edhe projektligji përkatës, por i cili nuk është miratuar.

Zyrtarë të qeverisë në largim thonë se një unifikim i sistemit të mbledhjes së të hyrave nuk është i nevojshëm. Luzim Rafuna, këshilltar i ministrit në largim të Financave, Bedri Hamza, në një prononcim për "Radion Evropa e Lirë" thotë se situata politike dhe ekonomike nuk është në favor të jetësimit të këtij unifikimi.

Rafuna thotë se është shumë e nevojshme që Dogana të qëndrojë në statusin aktual. "Dogana paraqet kufirin shtetëror, paraqet identitetin të shtetit dhe doganierët janë në të gjitha pikëkalimet kufitare duke përfshirë edhe Serbinë. Për këtë arsye, në situatën politike që ndodhemi sot, Dogana është shumë e nevojshme të qëndrojë me statusin që e ka. Elementi i dytë, sipas raportit të organizatave ndërkombëtare, është se niveli i zhvillimit të Doganës dhe ATK-së nuk është i njëjtë. Administrata Doganore është shumë më e zhvilluar sesa Administrata Tatimore. Dhe së treti, stafi doganor nuk është staf civil, është staf i uniformuar dhe ka komplet kushte dhe paga të tjera nga administrata", ka thënë Rafuna.

Edhe drejtori i Përgjithshëm i Doganës së Kosovës, Bahri Berisha, thotë se misioni i Doganës në disa fusha është

më ndryshe sesa ai i Administratës dhe për këtë arsye ai thotë se jo në të gjithë sektorët nevojitet bashkimi. Përveç mbledhjes së taksave doganore, tatimi mbi vlerën e shtuar, akcizën për buxhetin, kontrollimin e importit dhe eksportit, Berisha thotë se Dogana kontribuon edhe për sigurinë si në luftimin e aktiviteteve ilegale, rritjen e sigurisë përmes prezencës në pikat kufitare, siç janë luftimi i krimit kufitar, luftimi i trafikut të drogës, parandalimi i kontrabandimit dhe armëve.

Sipas tij, në këtë proces mund të integrohen vetëm disa njësi të këtyre dy institucioneve. "Ne vlerësojmë se jo gjithçka duhet të bashkohet, sepse Dogana parasheh sovranitetin shtetëror të një vendi. Kështu që mendojmë se në disa funksione duhet të ruhet pavarësia e saj sepse është me rëndësi qoftë në aspektin e sigurisë, qoftë në aspektin e luftës kundër krimit

transkufitar dhe në fushat e tjera që ka përgjegjësi Dogana", është shprehur Berisha për "REL".

Berisha thotë se pavarësia e Doganës duhet të ruhet sa i përket pranisë kufitare.

Megjithatë, ai shprehet se, nëse një vendim i tillë kërkohet nga qeveria, Dogana do të punojnë në këtë drejtim. "Sa i përket rolit të Doganës në praninë kufitare, praktikat në shumë vende të botës janë se Dogana ruan atë autonomi", ka theksuar Berisha, duke kërkuar që Dogana të krijojë kapacitete për të parandaluar edhe lloje të ndryshme të krimeve, nisur nga ato kibernetike dhe krimeve të tjera.

Kurse Lulëzim Rafuna thotë se disa nga vendet e Bashkimit Evropian, që më herët kishin përfunduar këtë proces, prapë i kanë ndarë këto agjenci në mënyrë që të funksionojnë në mënyrë të veçantë. "Unë rekomandoj që mos të bëhet bashkimi qoftë për arsye poli-

tike, qoftë për nivelin e zhvillimit të të dy administratave. Por, duhet të shikohet mundësia që të avancohet Administrata Tatimore, ndërsa të gjenden mundësitë për krijimin e një etniteti të veçantë i cili do të menaxhojë dhe administrojë Tatimin Mbi Vlerën e Shtuar", ka thënë Rafuna.

Administrata Tatimore e Kosovës është një agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Financave. Kjo agjenci mbledh tatimet dhe kontributet për ta mbështetur zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e qytetarëve të Kosovës.

Kurse Dogana e Kosovës, përveç detyrimeve doganore për mbledhjen e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSh-në), takson, akcizën nëpër kufij, mbron shoqërinë edhe nga kontrabandimi i drogës, mallrave të tjera të ndaluara me efekt të dëmshëm të krimit ekonomik si dhe evazionit në të hyra.



Bujar Tërstena (RFE/RL)

Shënohet ulje e transportit të mallrave me tren

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka njoftuar se në tremujorin e tretë të vitit 2019 numri i pasagjerëve që kanë shfrytëzuar trenin si mjet udhëtimi është rreth 30

000 krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2018, numri i udhëtarëve është rritur për 1.05 për qind. ASK-ja, duke iu referuar burimit të informatave, Trainkos Sh. A., ka njoftuar se

transporti i mallrave me tren në tremujorin e tretë të vitit 2019 është rreth 121 mijë tonë. Krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2018, kemi ulje për 20 për qind.



RAPORTI I INSTITUTIT ZVICERAN PËR R

Gazeta "Epoka e re" në vazhdimë do t'i botojë dy raportet e përkthyer në gjuhën shqipe, njërin prej 44 faqesh dhe tjetrin prej 15 faqesh, të Institutit të Mjekësisë Ligjore në Lozanë të Zvicrës, për rastin e Astrit Deharit. Këto dy raporte tashmë i ka Prokuroria Themelore në Prizren, familja e Astrit Deharit dhe avokati Tomë Gashi. Raporti publikohet pa asnjë ndërhyrje.

Sipas raportit AFK/2016-3193/2016-2859, profilet e ADN-së janë marrë praktikisht për të gjitha mostrat për të cilat testi paraprak për praninë e gjakut ka dhënë një rezultat pozitiv, përveç #10 (një shtupë) dhe #17 (një pjesë e hollë metalike). Në të kundërtën, kur testi ishte negativ, një profil i ADN-së është marrë vetëm për një sfungjer të rrethuar me një këmishë (majicë) (#12). Mostrat tjera për të cilat testi paraprak për praninë e gjakut ishte negativ nuk janë analizuar fare.

Gjithashtu, sipas raportit AFK/2016-3193/2016-2905, i profileve të ADN-së janë marrë për mostrat për të cilat testi paraprak për praninë e gjakut ka dhënë rezultat pozitiv, përveç xhemperit të zi (#A2) i cili nuk është analizuar. Një palë çorapë (#A5) për të cilat testi i gjakut në veçanti ishte negativ nuk është analizuar.

Nuk është saktësuar se cilat teknika janë përdorur për të zbuluar gjakun, praninë e materieve biologjike, as edhe cili është pragjet e koncentrimëve të ADN-së që janë përdorur për të deklaruar se nuk kishte ADN njerëzor ose jo mjaft ADN për ta analizuar.

• Tabelat e rezultateve

Tabelat e rezultateve të pranishme në raportet AFK/2016-3193/2016-2859 dhe AFK/2016-3193/2016-2905 tregojnë se të gjitha profilet e ADN-së janë komplete. Duke konsultuar EPG në dispozicion mbi DVD, mund të konstatohet se kështu nuk është rasti për profilin ADN të kampioneve #7.1. ky profil i ADN-së megjithatë mbetet i përputhshëm me profilin e ADN-së së z. DEHARIT.

2. Analizat e reja të ADN-së

Në funksion të informacioneve që kemi në dispozicion, ne jemi përpjekur të kryejmë kampione të reja mbi mostrat që na janë dukur të përshtatshme. Që do të thotë të vendeve ku mund të imagjinojmë praninë e ADN-së të ndonjë personi të tretë që ka bashkëvepruar me z. DEHARIN.

Ne kemi zgjedhur të bëjmë një kampion të dukshëm mbi tapën e shishes nga plastika (#5), t'i ekzaminojmë mbetjet e thonjve të dorës së djathtë (#D.D) dhe të majtë (#D.M) të z. DEHARIT dhe të orës së markës "MOWATCH" (#19).

Kampionet janë realizuar më 01.07.19. duke e hapur ambalazhin e mostrave, ne kemi konstatuar se mbështjellësit për të cilët mendohej se ruanin thonjtë (#D.D dhe #D.M), ishin të zbrazët. Ne e interpretojmë këtë vëzhgim me faktin se këto mostra duhej të konsumoheshin plotësisht gjatë analizave të rishqyrtuara nga "Agjencisë Kosovare të Forenzikës".

Më poshtë detajet e veprimeve të realizuara.

2.1. Metodat

Mostrat e transmetuara janë analizuar në veçanti me metodat e mëposhtme :

KAMPIONET

Kampionet janë marrë me përdorimin e shtupave 4N6LOQSwabs Gjenetik (COPAN) të lagur me një pikë uji steril (një shtupë për secilin kampion).

NXJERRJA E ADN-SË

Protokolle të ndryshme zakonisht janë përdorur në UGF me qëllim të nxjerrjes pastaj pastrimi i ADN-së mundësisht të pranishëm në kampione. Protokolle të ndryshme të ndryshme të karakteristike të këtij kampioni.

PËRCAKTIMI I SASISË SË ADN-SË

Koncentrimi i ADN-së mashkullor dhe i ADN-së së përgjithshme (Mashkullor dhe femëror) të pranishme në kampione janë përcaktuar para amplifikimit me një mjet të një PCR sasior në kohën reale me kit Kuantifikim Trio (Applied Biosystems) në një Aparat Biosistem 7500 Real-Time PCR System.

AMPLIFIKIMI I ADN-SË

ADN-ja ekstrakt i kampionit është plotësuar me PCR duke përdorur të paktën një nga pajisjet e mëposhtme: AmpFISTR NGM Select i versionit standard ose ekspres (Applied Biosystems), NGM Detect (Applied Biosystems), PowerPlex ESI 17 Sistem i shpejtë (Promega). Këto kite mundësojnë analizën e 16 vendeve që gjenden në kromozomet autosomale dhe japin indikacione sa i përket llojit të personit në origjinën e materialit biologjik të analizuar.

ELEKTROFOREZA

Një aparat i elektroforezës kapilar Applied Biosystems 3500xL është përdorur për ta ndarë dhe zbuluar ADN-në e përforuar.

Informacione plotësuese për metodat e përdorura mund të merren sipas kërkesës. Në pajtim me urdhëresën e DFJP në laboratorët r analizës së ADN-së (RO 363.11), rezultatet e analizave të ADN-së janë konfirmuar me së paku dy analiza të pavarura.

2.2. Materiali dhe rezultatet

Nr. i laboratorit: 19-T03497a

Nr. tjetër : #5

Materiali i pranuar : një shishe prej plastike



Data e pranimit : 22.05.19; data e kampioneve : 01.07.19

MATERIALI I ANALIZUAR

Një shtupë e marrë nga kapaku i verdhë i shishes.

ANALIZA E ADN-së MBI KROMOZOMET AUTOSOMALE

Karakteristikat : Profili i ADN-së së përzierjes, fraksioni i madhe korrespondojnë me një profil tjetër, fraksioni i vogël jo i interpretueshëm.

Gjinia : M vendndodhja e Nb NGM SElesct : 16

Komentimi : korrespondojnë me profilin e ADN-së të z. DEHARI Astrit

Nr. i laboratorit: 19-T03497b

Nr. tjetër : #D.D

Materiali i pranuar : zarfet që supozohet se përmbanin mbetjet e thonjve të dorës së djathtë të z. DEHARI Astrit

Data e pranimit : 22.05.19; data e hapjes së zarfeve : 01.07.19

MATERIALI I ANALIZUAR

Nuk ka kampion sepse zarfi ishte i zbrazët.

Nr. i laboratorit: 19-T03497c

Nr. tjetër : #D.M

Materiali i pranuar : zarfet që supozohet se përmbanin mbetjet e thonjve të dorës së djathtë të z. DEHARI Astrit

Data e pranimit : 22.05.19; data e hapjes së zarfeve : 01.07.19


MATERIALI I ANALIZUAR

Nuk ka kampion sepse zarfi ishte i zbrazët.

Nr. i laboratorit: 19-T03497d

Nr. tjetër : #19

Materiali i pranuar : një orë e markës "MOWATCH"



Data e pranimit : 22.05.19; data e hapjes së zarfeve : 01.07.19

MATERIALI I ANALIZUAR

19-T03497d1 : Një shtupë e marrë në faqen e jashtme të rripit dhe të kuadrit të orës.

19-T03497d2 : Një shtupë e marrë në faqen e brendshme të rripit (që prek lëkurën) dhe të kuadrit të orës.

ANALIZA E ADN-së MBI KROMOZOMET AUTOSOMALE

19-T03497d1

Karakterizimet : Profili i ADN-së së përzierjes, fraksioni i madh vjen nga një njeri i panjohur, fraksioni i vogël jo i interpretueshëm.

Gjinia : M vendndodhja e Nb NGM SElesct : 14

Komentimi : H1

19-T03497d2

Karakterizimet : Profili i ADN-së jo i interpretueshëm

vendndodhja e Nb NGM SElesct : 14

Komentimi : -

2.3. Vërejtje dhe interpretimi

"Agjencisë Kosovare të Forenzikës" e ka amplifikuar ADN-në me mjetin e kitit Identifier (Applied Biosystems) i cili përmban 16 lokus. Kiti NGM Select (Applied Biosystems) që ne e përdorim përmban gjithashtu 16 lokus. Në përgjithësi 10 lokuse janë të përbashkëta për të dy kite.

• Kampioni e kryera mbi kapakun e verdhë të shishes së mjaltit prej plastike (#5)

Ky kampion përmban shumë ADN. Na ka mundur të marrim një profil të ADN-së së përzierjes. Ai është i përbërë nga një fraksion i madh që është dukshëm i një personi të vetëm. Profili i ADN-së i këtij kontribuuesi të madh ka qenë i krahasuar me profilin e ADN-së i referimit të z. DEHARI Astrit i përdorur nga "Agjencisë Kosovare të Forenzikës" (#A.D). Këto profile korrespondojnë me 10 lokuse në dispozicion për t'i krahasuar. Fraksioni i vogël është dobët i pranishëm, por nuk është i shfrytëzueshëm.

ASTIN E VDEKJES SË ASTRIT DEHARIT

Profilin e ADN-së së z. DEHARI Astrit dhe i fraksionit të madh të kampionit të kryer mbi kapakun e verdhë të shishes prej plastike (#5) korrespondojnë me 10 lokuse në dispozicion për t'i krahasuar. Me qëllim që të përcaktojmë sa i përket vlerës provuese të kësaj korrespondence, ne e kemi marrë parasysh probabilitetin e rezultateve të vëzhguara në funksion të propozimit sipas të cilit z. DEHARI Astrit është kontribuuesi më i madh i përzjerjes së ADN-së të theksuar për gjurmën në fjalë në krahasim me probabilitetin e këtyre rezultateve në funksion të propozimit alternativ sipas të cilit kemi të bëjmë me një të panjohur që nuk lidhet me z. DEHARI Astrit. Raporti i probabilitetit është quajtur raport i mundësisë(gjasave).

Raporti i mundësisë i rendit të një miliardi është atribuuar duke konsideruar që kemi të bëjmë me një korrespondencë mbi 10 lokuse (Foreman and Evett 2001).

Ky raport i gjasave tregon se ka të ngjarë me miliarda herë se është më se e mundur që të vëzhgohen rezultatet e analizës sonë sikur z. DEHARI Astrit të jetë kontribuuesi kryesor i përzjerjes së ADN-së, së theksuar, për kampionet e realizuara mbi kapakun e verdhë të shishes së plastike (#5) më parë se sa që kemi të bëjmë me një të huaj jo i dukshëm për këtë person.

Interpretimi i mundshëm i rezultateve është i kushtëzuar nga informacionet të cilat na janë transmetuar. Në rast se këto informacione nuk do të jenë korrekte, apo nëse elemente të reja do të dalin në shesh, një interpretim i ri do të jetë i nevojshëm. Ky interpretim në asnjë mënyrë nuk informon për mekanizmat ose veprimet që çuan në posedimin e materialit biologjik në fjalë, por siguron vetëm informacione për origjinën e tij.

• Kampionet e realizuara mbi orën e markës "MOWATCH" (#19)

Kampionet e realizuara mbi faqen e jashtme të rripit dhe kuadrit të orës së markës "MOWATCH"(19-T03497d1) ka mundësiar të kemi një profil të ADN-së së përzjer. Ai është i përbërë nga një fraksion madhor i pjesëshëm (14/16 lokuse) me prejardhje nga një person i panjohur që ne e kemi emëruar H1. Ky profil i ADN-së është ndryshe nga ai i z. DEHARI Astrit (#A.D). një fraksion minor në veçanti është i pranishëm. Ky megjithatë nuk është i realizueshëm.

Kampionet e kryer mbi faqen e brendshme të rripit dhe kuadrit të orës (19-T03497d2) nuk na ka mundësiar të kemi një profil të realizueshëm të ADN-së.

3. Bilanci i analizave të ADN-ës dhe përfundimet

3.1. Analizat e realizuara nga "Agjencisë Kosovare të Forenzikës"

- Profilin e marra nga "Agjencia Kosovare e Forenzikës" të ADN-së janë të cilësisë së mirë. Ata korrespondojnë të gjithë me profilin e ADN-së së z. DEHARI Astrit dhe nuk paraqesin karakteristika të përzjerjeve të ADN-së. Studimi i rezultateve analitike të ofruara (elektroforegrameve të DVD) konfirmojnë interpretimin i cili është bërë. Këto rezultate janë të pajtueshme me faktin se kemi të bëjmë kryesisht me mostra për të cilat testi i zbulimit të gjakut ishte pozitiv, pra që përmban sasi të theksuara të ADN-së. Vetëm një profil i ADN-së është marrë për një mostër për të cilën testi i pranisë së gjakut ishte negativ (#12).
- Duke u bazuar mbi përmbajtjen e raporteve AFK/2016-3193/2016-2859 dhe AFK/2016-3193/2016-2905, është vështirë, themi e pamundur, të bëhet lidhja ndërmjet të lokalizimit të kampionëve të cilat janë realizuar dhe rezultateve të cilët janë fituar. Në veçanti, asnjë listë gjithëpërfshirëse e kampionëve, të lokalizimit të tyre dhe të përshkrimit të rezultateve të fituara për secilin nga ata që nuk shihet në këto raporte.
- Në mesin e mostrave/kampionëve të cilët janë marrë në konsideratë, me dhjetëra të tilla nuk i janë nënshtruar analizave të ADN-së. Sipas raporteve AFK/2016-3193/2016-2859 dhe AFK/2016-3193/2016-2905 këto mostra nuk ishin analizuar pasi që shumë pak ose fare ADN nuk është zbuluar. Asnjë prag i zbulimit nuk është paraqitur në raporte. Për ndryshe, kuantifikimi i ADN-së nga PCR në kohën reale nuk është saktësuar mjaftueshëm për të përcaktuar mënyrën e besueshme nëse një profil i ADN-së i realizueshëm do të mund të fitohet apo jo. Në veçanti, profilet e ADN-ve të realizueshme mund të merren edhe nëse koncentrimi i ADN-së së matur me PCR në kohën reale është bars me zero (e.g. M Poetsch dhe al. 2016). Për tri mostra të pa analizuara, është thënë se ato nuk përmbanin gjak ose materie tjetër biologjike. Metoda e detektimit dhe pragu nuk janë saktësuar. Në mesin e tyre figurojnë në veçanti një orë (#19), një xhemper i zi ("A2) dhe një palë çorapë (#A5). Do të mund të pritim që këtu të vërejmë ADN njerëzore, sikur të dihet se rrobat kanë qenë veshur. Rezultatet e fituara për mostrën #A2 (një xhemper i zi) janë të papritura sepse gjaku është detektuar, megjithatë analizat e ADN-së nuk janë realizuar sepse shumë pak ADN ishte i pranishëm sipas raportit në fjalë.

• Analizat e realizuara me CURML

Analizat e realizuara me CURML nga një kampion në pjesën e jashtme të orës së z. DEHARIT kanë vënë në pah praninë e një ADN-ja me prejardhje nga një njeri i panjohur të cilin ne e kemi emëruar H1. Profili i ADN-së së H1 mund të krahasohet me profilet e ADN-ve të personave të njohur.

3.2. Përfundimi

Sipas raporteve AFK/2016-3193/2016-2859 dhe AFK/2016-3193/2016-2905, të gjitha profilet e ADN-së të fituara nga "Agjencia Kosovare e Forenzikës" korrespondojnë me profilin e ADN-së së z. DEHARI Astrit. Këto profile të ADN-ve kryesisht janë fituar duke u nisur nga gjurmët që kanë reaguar pozitivisht në testin e detektimit të gjakut. Nag gjurmët që kanë reaguar negativisht në këtë test, vetëm një profil i ADN-së është fituar ndërsa gjurmët tjera nuk janë analizuar fare. Përqindja e ultë e sukseseve të fituara për këto gjurmë sugjerojnë se procedura analitike e përdorur nga "Agjencia Kosovare e Forenzikës" nuk ishin shumë të ndjeshme.

Si ilustrim "Agjencia Kosovare e Forenzikës" nuk i ka analizuar kampionet e realizuara mbi orën e z. DEHARI Astrit të cilët, sipas tyre, përmbanin shumë pak ADN. Ne ia kemi dalë të fitojmë një profil të ADN-së që kishte prejardhje nga një njeri i panjohur i emëruar H1 përmes një kampioni të ri të realizuar mbi të njëjtën orë. Kjo sugjeron se profilet e ADN-ve potencialisht do të mund të merreshin edhe për gjurmët tjera të cilat nuk janë analizuar nga "Agjencia Kosovare e Forenzikës". Analizat e tilla do të mund të realizoheshin duke u nisur nga ADN-të trashmë të nxjerra nga "Agjencia Kosovare e Forenzikës" ose duke u nisur nga kampionet e realizuara nga CURML, për sa kohë që është ruajtur materiali.

Është gjithashtu e rëndësishme të saktësohet se nuk është e mundur të përcaktohet kur dhe si një ADN është vendosur mbi një bartës. Pra nuk është e mundur të lidhet një person me një veprimtari bazuar në praninë e thjeshtë të ADN-së së tij (duke u nisur nga parimi se origjina e kësaj ADN-je nuk do të kontestohet). Elementet tjera të hulumtimeve duhet të konfirmojnë informacionet e sjella nga ADN-ja. Në këtë kuptim, profili i ADN-së së njeriut të panjohur H1 i vënë në pah në saj të analizave të realizuara nga CURML do të duhej të shfrytëzohej me kujdes. Me kërkesë, profili i ADN-së të H1 do të mund të krahasohet me profilet e ADN-ve të personave që kanë të bëjnë me këtë aferë. Nuk është e mundur të përcaktohet nëse depoja e kësaj ADN-je është në lidhje me vdekjen e z. DEHARI Astrit apo nëse është vënë përpara apo pas vdekjes, për shembull gjatë zhvendosjes ose transportit të trupit.

4. Literatura

- LA Foreman and IW Evette (2001). "Statistical analyses to support forensic interpretation for a new ten-locus STR profiling system" Int J Legal Med 114(3) : 147-155
- M Poetsch et al. (2006) "Does zero really mean to mean nothing?-first experiences with the new PowerQuant(TM) system in comparison to established real-time quantification kits." Int J Legal Med 130: 935-940

Mbesin në dispozicion tuajin për të gjitha njoftimet plotësuese, ju lusim që të pranoni përsëritetjet e veçanta.

M Sc C. GEHRIG
(nënshkrimi i palexueshëm)
Geneticien forensique SSML

Dre s Sc V. CASTELLA, PD, MER
(nënshkrimi i palexueshëm)
Geneticien forensique SSML

Unë, i poshtë nënshkruari, Ismail Ismaili, përkthyesi-interpret gjyqësor i autorizuar nga Gjykata e Qarkut në Gjiçan, më vendimin nr. 238/2009 e vërtetoj saktësinë dhe autorësinë e përkthimit nga gjuha frënge në gjuhën shqipe. Në dëshmi të kësaj, kam vendosur nënshkrimin time dhe vulën e datës 19 tetor, 2009, në Prishtinë, Kompania e përkthimeve « Prestige », Rr. Garibaldi, hyrja 5/5, Prishtinë. Nr. I kontaktit +383 45 20 21 21 perkthimeprestige@gmail.com.

Përkthyer më 20.10.2019 në Prishtinë

III. Konkluzionet

Në bazë të të gjitha elementeve që kemi në dispozicion dhe në vazhdimin e analizës së kryer në laboratorët tona ne mund të pranojmë konkluzionet e më poshtme :

1. Ashtu siç është thënë në ekspertizën tonë EI180001, ne kemi dyshime që lidhen me rrethanat e vdekjes së z. DEHARI Astrit. Në fakt hipoteza e një vetëvrasjeje e z. DEHARI Astrit përmes mjeteve të caktuara nga mjekët ligjor duket pak e vërtetë dhe intervenimi i një personi të tretë në proces fatal duhet të kihet parasysh.
2. Analizat e ADN-së të kryera në laboratorët tona kanë mundësiar të vëjnë në dritë një profil të ADN-së mbi mostrën e përshkruar nga ekspertët e Kosovës siç thuhet se përmbanë pak ose shumë pak ADN.
3. Nga ajo çfarë u tha, ne vlerësojmë se një hetim i ri është i nevojshëm për t'i qartësuar rrethanat e vdekjes së z. DEHARI Astrit. Ekipet tona dhe laboratorët tona janë në dispozicion të hetuesve të ngarkuar me çështjen.

Materiali që është vënë në dispozicion nga CURML do të ruhet në pritje të udhëzimeve të reja nga ana e mandatit ton.

(nënshkrimi i palexueshëm)

Prof Dr med. T. FRACASSO
Specialist FHM në mjekësi ligjore
Mjek-shef

(nënshkrimi i palexueshëm)
20.06.19

Prof. Dre med. S. GRABHERR
Specialist FHM në mjekësi ligjore
Drejtoreshë e CURML

Dre s Sc V. CASTELLA, PD, MER
(nënshkrimi i palexueshëm)
Geneticien forensique SSML

Protesta antiqeveritare në Bagdad

BAGDAD, 3 NËNTOR - Protestuesit antiqeveritar në kryeqytetin e Irakut kanë mbyllur rrugët kryesore.

Shkollat dhe zyrat e qeverisë janë gjithashtu të mbyllura në Bagdad dhe qytetet e tjera të Irakut të dielën, fillimi i javës së punës në vendin me shumicë myslimane, pasi demonstruesit dolën në rrugë për të kërkuar ndryshim të sistemit politik të vendit.

Të shtunën në Bagdad u zhvillua një tjetër demonstratë për të

sfiduar shtypjen e protestave nga qeveria.

Dhjetëra-mija irakianë u mblodhën të premten në Sheshin Tahrir të Bagdadit në demonstratën më të madhe antiqeveritare që nga fillimi i protestave një muaj më parë.

Protestuesit me flamuj mbushën sheshin dhe bulevardet para lutjeve të së premtes. Protestat, të cilat filluan një muaj më parë, janë rritur në madhësi ditët e fundit, me demonstruesit që sfidojnë forcat e sigurisë që

kanë vrarë shumë njerëz. Zyrtarët e sigurisë dhe mjekësisë thonë se të paktën 225 njerëz kanë vdekur në muajin e kaluar, përfshirë pesë persona që vdiqën të premten nga plagët e marra më parë.

Disa nga protestuesit të premten drejtuan zemërimin e tyre drejt Iranit, i cili ka lidhje të ngushta me disa parti politike në vend.

Protestat janë pa lider, pa një strukturë organizative dhe ato nuk janë të unifikuara.



Çfarë po ndodh me hetimin ndaj presidentit Trump

Donald Trumpi është presidenti i katërt amerikan që bëhet objekt i një hetimi për shkarkim lidhur me dyshimet se u përpoq t'i bëjë presion udhëheqësve të Ukrainës të hetojnë kundërshtarin e tij politik Joe Biden

UASHINGTON, 3 NËNTOR - Kongresi bëri histori të enjten me një votim që zyrtarizoi hetimet për ngritjen e akuzave për shkarkimin e presidentit Donald Trump. Trumpi është presidenti i katërt amerikan që bëhet objekt i një hetimi për shkarkim lidhur me dyshimet se u përpoq t'i bëjë presion udhëheqësve të Ukrainës të hetojnë kundërshtarin e tij politik Joe Biden, ka njoftuar voa.

Uashingtoni është përfshirë nga ethet ndërsa Kongresi po bën përpara me hetimin për shkarkimin e presidentit që udhëhiqet nga kryetarja e Dhomës së Përfaqësuesve Nancy Pelosi.

Pelosi dhe shumë demokratë të tjera besojnë se presidenti Trump abuzoi me pushtin duke i bërë presion Ukrainës t'i hetojë një nga kundërshtarët e tij politikë, ish-nënpresidentin Joe Biden.

"Ne zotohemi të mbrojmë Kushtetutën dhe këtë gjë nuk mund ta injorojmë. Nuk mund ta injorojmë kur sjellja e presidentit tregon se hetimi për ngritjen e akuzave zyrtare për shkarkimin e tij është i nevojshëm", tha Pelosi. Republikanët e Dhomës së Përfaqësuesve janë të bashkuar kundër hetimit. Udhëheqësi

republikan Kevin McCarthy thotë se demokratët po përpiqen të zhbëjnë fitoren e Trumpit në zgjedhjet e vitit 2016.

"Demokratët po përpiqen të akuzojnë presidentin pasi kanë frikë se nuk mund ta mposhtin atë me votë. Këto nuk janë fjalët e mia, këto janë fjalët e kolegëve të mi demokratë, që kanë nisur procedurat për shkarkim në tre periudha të ndryshme", tha ai.

Në një postim në Twitter, presidenti e kritikoi miratimin e rezolutës që zyrtarizoi hetimet duke e cilësuar si "gjueti shtrigash". Jo për herë të parë ai u zotua t'i mbi-jetojë çdo përpjekje për ta larguar nga detyra.

"Kam kaluar gjuetinë e shtrigave të Muellerit, atë që lidhet me hetimet mbi Rusinë. Kam një gjueti shtrigash çdo javë. Ndonjëherë mendoj cila është gjuetia e shtrigave këtë javë? Ata nuk na mundin dot në kutinë e votimit ndaj përpiqen të na mundin me metoda të vjetra që nuk janë aspak serioze. Ata janë një grup njerëzish të poshtër", tha presidenti Donald Trump.

Votimi më i fundit në Dhomën së Përfaqësuesve i jep një shtysë procesit të hetimit thotë gazetarja



e agjencisë Associated Press Julie Pace.

"Ka të bëjë me rregullat që do të udhëheqin procesin në vazhdim, atë që lidhet me dëshmitë publike dhe asaj që publiku duhet të dijë rreth seancave dëgjimore me dyer të mbyllura", tha ajo.

Vota në Dhomën e Përfaqësuesve nisi një kapitull të ri të rëndësishëm të hetimeve thotë analisti John Hudak.

"Një pjesë e arsyes për ta bërë këtë është transferimi i procesit në fazën tjetër, në fazën publike të tij, por gjithashtu për t'i bërë presion republikanëve që të mos

kenë më argumente kundër procedurës që është ndjekur për hetimin", tha John Hudak, i Institutit Brookings.

Por ky do të jetë një proces që mund të zvarritet për ca kohë, thotë analisti John Fortier.

"Në Dhomën e Përfaqësuesve ka të ngjarë që do të zgjasë për disa muaj. Jemi vetëm në fillim të procesit të hetimit. Nëse do të ketë gjykim në Senat dhe drejtuesi i mazhorancës në Senat tha se do të ketë, nëse do të ngrihen zyrtarisht akuzat për shkarkimin e presidentit, ka të ngjarë që edhe ky proces të zgjasë një muaj ose dy

muaj. Pra kjo çështje mund të vazhdojë edhe për gjatë vitit të ardhshëm", thotë John Fortier, i Qendrës për Politika Dypalëshe.

Një votim i Dhomës së Përfaqësuesve për të ngritur zyrtarisht akuzat për shkarkimin e presidentit do të ishte i barasvlershëm me një aktakuzë për shkelje të ligjit.

Kjo do të çonte çështjen për gjykim në Senat, ku senatorët do të vendosnin nëse do ta largojnë ose jo presidentin nga detyra. Seancat dëgjimore publike lidhur me hetimin pritet të fillojnë më vonë gjatë këtij muaji.

Irani përjashton mundësinë e bisedimeve me ShBA-në

TEHERAN, 3 NËNTOR - Udhëheqësi Suprem i Iranit ka përjashtuar mundësinë e bisedimeve me Shtetet e Bashkuara si një mjet efektiv për të bllokuar ndërhyrjen amerikane në vend.

Ayatollah Ali Khamenei u tha studentëve në një fjalim që u transmetua në televizionin shtetëror një ditë para 40 vjetorit të marrjes së Ambasadës amerikane në Teheran, se negociimi me Shtetet e Bashkuara do të thoshte që Irani

po i nënshtrohej politikës së tyre maksimale të presionit.

Khamenei paralajmëroi se "përvojat e Kubës dhe Koresë së Veriut janë para syve tuaj", duke shtuar se negociatat mes Uashingtonit dhe dy vendeve të tjera nuk kishin çuar në uljen e sanksioneve.

Tensionet kanë qenë të larta mes Uashingtonit dhe Teheranit pasi presidenti Donald Trump tërhoqi në mënyrë të njëanshme Shtetet e Bashkuara nga marrëveshja

bërthamore e Iranit 2015.

ShBA-ja ka kërkuar të sprapsin ndikimin e Iranit në të gjithë rajonin duke vendosur sanksione dhe duke ofruar ndihmë ushtarake dhe ndihma të tjera për kundërshtarët e tij.

Këto sanksione e kanë ndaluar Iranin të shesë naftën e tij jashtë vendit dhe e kanë dëmtuar ekonominë e tij. Qysh atëherë Irani ka filluar të shkelë kushtet e marrëveshjes bërthamore.







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



E jashtëzakonshme

Elefanti vendos të ulet sipër makinës me udhëtarë

Të gjitha makinat e tjera kaluan, por elefanti te parku kombëtar Kao Jai në Tajlandë vendosi se kjo makinë, specifikisht, nuk duhej të kalonte. Kafsha e stërmadhe u ul sipër makinës dhe arriti t'i shkaktojë dëme. Për fat, elefanti vendosi të mos jetë më i dhunshëm se aq dhe



e lejoj makinën të largohet. Udhëtarët dolën pa dëme, ndërsa makina pati dëme minimale.

FOTO E DITES



Një peshkatar në Brazil mbart në shpinë një peshk të madh. /AFP/

E rrallë

Nisin hetimet, piloti i lë të dashurës "një xhiro" avionin me 50 udhëtarë

Videoja e një gruaje që i jep avionit komercial me 50 udhëtarë brenda, teksa piloti e udhëzon, ka bërë që të hapet një hetim në Rusi. Gruaja, e quajtur Ana, pa asnjë kualifikim si pilote, është e dashura e pilotit, të quajtur Kirill. Ajo është filmuar te komandat e avionit, ndërkohë që zëri



i pilotit dëgjohej teksa i jep udhëzime. Ana e kishte postuar videon në "Instagram", por tani është fshirë. Kompania ka thënë se dyshojnë që pamjet s'kanë lidhje me transportimin e udhëtarëve nga ana e tyre, por prokuroria ka nisur tashmë hetimet.

BARSOLETA E DITËS



Goni: Alo, policia!
 Polici: Si mund t'ju ndihmoj?
 Goni: Jam në një vend ku janë duke më mbajtur me zor.
 Polici: Djalosh, më trego ku je?
 Goni: Xhaxhi polic, jam në shkollë.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjatë vikendit në ora

14:00

ABOMINABLE 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 32 min

Rolet: Chloe Bennet, Tenzing Norgay Trainor, Albert Tsai, Eddie Izzard, Sarah Paulson, Tsai Chin, Michelle Wong, etj.
 Regjia: Jill Culton



Çdo ditë në ora 16:00

TOY STORY 4 / 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 40 min

Rolet: Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj.
 Regjia: Josh Cooley



Çdo ditë në ora 18:00 dhe 20:00

MALEFICENT MISTRESS OF EVIL 3D

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 orë 58 min

Rolet: Angelina Jolie, Elle Fanning, Chiwetel Ejiofor, Sam Riley, Ed Skrein, Imelda Staunton, Juno Temple, Michelle Pfeiffer, etj.
 Regjia: Joachim Ronning



Çdo ditë në ora 22:00

ZOMBIELAND DOUBLE TAP

Aksion/Komedi/Horror; 1 orë 39 min

Rolet: Woody Harrelson, Jesse Eisenberg, Emma Stone, Abigail Breslin, Rosario Dawson, Zoey Deutch, Luke Wilson, etj.

Regjia: Ruben Fleischer



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).




DASHI

Ka gjasa ta arrini qëllimin për të kursyer, për të cilin do t'ju mbështesë edhe partneri/partnerja juaj.



DEMI

Nëse nuk ndiheni mirë në vendin e punës, rekomandohet të kërkontë diçka tjetër.



BINJAKËT

Do të vlerësoheni maksimalisht për punën e lodhshme gjatë këtyre ditëve.



GAFORRJA

Gaforret duhet të veprojnë me qetësi. Ka gjasa që gjatë kësaj dite t'ju vihen në rrezik ato që keni arritur me shumë mundim.



LUANI

Disa luan do ta kalojnë ditën duke u kënaqur dhe duke qenë në harmoni me të gjitha sferat e jetës.



VIRGJËRËSHA

Virgjëreshat do t'i përmbahen planit të ditës së sotme, pavarësisht prej disa problemeve me të cilat mund të përballen.



PESHORJA

Një surprizë gjatë ditës së sotme do t'ju kënaqë shumë.



AKREPI

Disa akrepa do të ndihen të lodhur këtë të hënë dhe nuk do të kenë dëshirë të përfshihen në aktivitete të ndryshme.



SHIGJETARI

Do t'ju duhet të sqaroni një çështje të caktuar gjatë kësaj të hëne.



BRICJAPI

Ekziston mundësia që gjendja juaj financiare të përmirësohet.



UJORI

Për shumë ujorë do të jetë një ditë mjaft e ngarkuar në punë. Megjithatë, mendoni pozitivisht dhe tregoni durim, pasi jo çdo ditë është e njëjtë.



PESHQIT

Ka gjasa të merrni një vendim të rëndësishëm, çfarë do ta forcojë marrëdhënien tuaj në çift.

Dua Lipa nxjerr këngën e re, bëhet më e kërkuara në Shazam



Dua Lipa është gati të futet në një epokë të re, sipas "Forbes", me këngën e re "Don't Start Now". Kënga e saj e re jo vetëm se ka marrë miliona

klikime në "Youtube", por ka dalë dhe "Kënga e ditës" në Shazam, që do të thotë se është muzika që kanë kërkuar më shumë njerëzit në aplikacionin që identifikon këngët.

Bashkëshortja e Dani Alvesit shkëlqen



Joana Sanz ka bërë një udhëtim në Napoli, ku ka vizituar edhe të famshmin Bregun e Amalfit, prej ku ka realizuar edhe disa fotografi seksi dhe madhështore. Bashkëshortja e

mbrojtësit brazilian Dani Alves ka vendosur të ndajë me ndjekësit në "Instagram" fotografi dhe video nga Bregu i Amalfit, duke i bërë një reklamë edhe më të madhe këtij të fundit.



Personit që ngjan me Michael Jacksonin i kërkohet ta bëjë testin e ADN-së

Një personi i cili ka një ngjashmëri me Michael Jacksonin i është kërkuar për të bërë një test të ADN-së që të vërtetojë se nuk është ai. Sipas një teorie të çuditshme, Jacksoni falsifikoi vdekjen e tij. Një video e publikuar ka bërë që fansat të

kërkojnë që Sergio Cortes të bëjë një test për ta provuar teorinë e tyre. Sergio me origjinë nga Barcelona ka grumbulluar mijëra ndjekës falë videove të tij si Michael Jackson. Ai ka të njëjtat lloje dhe tipare tërheqëse sikurse që kishte idhulli i tij.

Vdes aktori Brian Tarantina



Aktori Brian Tarantina ka ndërruar jetë në moshën 60-vjeçare. "TMZ" ka raportuar se ai u gjet i vdekur në mëngjesin e së shtunës në apartamentin e vet në Nju Jork, nga një

mbidozë e dukshme e drogës. Mbesa e tij shkoi ta kontrollonte dhe e gjeti atë të vdekur në shtrat. Ajo u tha policëve se hera e fundit që foli me të ishte të martën që lamë pas.


Si dhe përse të

Nga: Harold BLOOM
Përktheu: Granit ZELA

Leximi nuk duhet reshtur kurrë, sepse ai ka rëndësi të dorës së parë, për ta mbajtur sadopak gjallë aftësinë e formimit të gjykimit dhe mendimeve vetjake. Mënyra se si lexohet, mirë a keq, nuk mund varet vetëm prej nesh, porse arsyeja përse lexohet duhet me qenë vetëm e vetëm në shërbim të interesit tonë. Mund të lexohet thjesht për të vrarë kohën, sikurse mund të lexohet i yshtur prej një nevoje të thellë të brendshme, në një rast të këtyllë, ka për të mbërritë më së mbrami ai çasti i pangishëm kur leximi do të ta bëjë natën ditë. Lexonjësit e Biblës, ata që përqipen me gjetë biblën e vetvetes, ndoshta e trupëzojnë këtë nevojë të brendshme shumë më mirë se lexuesit e Shekspirin, porse në të dyja rastet, prapëseprap, grishja është po ajo. Një nga shërbimet e të lexuarit, është të na përgatisë për ndryshimin tonë, dhe ndryshimi më i fundmë, ajme, është univesal.

Mua leximi më shëmbëllen me një ritual vetmitar, më shumë se me një mision edukues. Mënyra se si lexojmë sot, kur jemi vetëm me veten tonë, përbën deri diku një vazhdimësi të leximit në të shkuarën, sidoqë sot leximi interpretohet nëpër akademi. Lexuesi im ideal (sikurse heroi im i përjetshëm) është Dr. Samuel Johnson-i, i cili ishte i vetëdijshëm për të dyja, fuqinë dhe pamundësinë e të lexuarit pareshtur. Sikurse çdo aktivitet tjetër i mendjes, ai duhet të përmush parimin e parë të Johnson-it, leximin e asaj "çka na përshtatet më së miri, çka na sjell dobi." Sër Francis Bacon, përhapësi i disa prej ideve që Johnson-i vuri në jetë, pat dhënë një këshillë shumë të vyer "Lexo duke ruajtur gjykimin, pa t'u bërë trutë dhallë, duke mos besuar gjithçka mendjen pa e vrarë, jo për të rrahur ujë në havan me fjalë që s'kanë mbarim, por duke i dhënë peshë mendimit, duke u thelluar në gjykim." Unë do të vija përkrah Bacon-it dhe Johnsonit, një tjetër mendimtar të urtë, Emersonin, të ashprin armik të historisë dhe historicismave të çdo lloji, i cili pat theksuar se librat më të mirë "na trondisin me bindjen e thellë, se ajo nevojë e brendshme që shkruan, po ajo lexon."

Lejomëni atëherë të bëj njësh thëniet e Bacon-it, Johnson-it, edhe Emerson-it, për të përfutur një formulë të vetme se si të lexojmë: lexo çka më së miri të përshatatet, çka të sjell dobi, libra që i japin peshë mendimit duke të thelluar në gjykim, libra që të trondisin ngase keni të njëjtën natyrë, të pacënuar nga e tirani e kohës. Pikë për pikë, kjo do të thotë, në fillim



gjejeni ju Shekspirin, mandejlëreni t'ju gjej. Nëse leximi i Mbreti Lir, ju rrëmben të tërin, atëherë mendoni e gjykoni për natyrën e njëjtë që personazhi ndan me ju; afrinë me veten tënde. Vetëmse këtë s'e shoh asfare si idealizëm por si pragmatizëm. Ta gjykosh këtë tragjedi si akuzë kundër sistemit patriarkal do të thotë të heqësh dorë nga interesat e tua më vetjake, sidomos kur kemi të bëjmë me lexuese, çka është më ironike se sa duket. Shakespeare, më shumë se sa Sophocles, përbën një autoritet të padiskutueshëm dhe të pashmangshëm për sa i përket konfliktit ndërmjet brezave, dhe më shumë se kushdo tjetër, në lidhje me ndryshimet ndërmjet grave dhe burrave. Jini të hapur kundrejt një leximi të shumëanshëm të Mbreti Lir, dhe kësisoj do të kuptoni shumë më mirë origjinën e asaj çka ju e quani patriarkat. Në fund të fundit – ne lexojmë – sikurse Bacon-i, Johnson-i, dhe Emerson-i do të ishin të një mendjeje – për të forcuar univ tonë, për të mësuar interesat e tij të qenësishme. Leximi na trand së brendshmi duke na dhënë ndiesi të atilla kënaqësi të cilat shpjegojnë deri diku se përse vlerat estetike janë nënvlerësuar nga moralistët socialë, qysh prej Platonit deri tek kampi i sotshëm i puritanëve. Kënaqësitë leximore janë në të vërtetë egoiste më shumë se sociale. Nuk është se përmirësohet

drejtpërdrejt jeta e ndokujt nëse leximi është më i mirë e më i thellë. Mbetem mosbesues ndaj shpresës tradicionale sociale se kujdesi ndaj të tjerëve mund të nxitet prej gjallërimit të imagjinatës vetjake, sikurse jam i tejnginjur me argumentat e gjertanishme që përquasin ëndjet e leximit vetmitar me të mirën publike.

Ajo çka është e trishtueshme sa i përket leximit në mënyrë profesionale është fakti se rrallë ndodh të ndiesh sërish atë mrekullim të dikurshëm që të ngjallte leximi në rini, atëkohë kur librat mbartnin "mrekullimin hazlitian". Mënyra se si lexojmë sot, varet deri diku apo plotësisht nga largësia, qoftë kjo e brendshme apo e jashtme, që ne vendosim në lidhje me universitetet, vendet ku leximi rrallë mësohet si kënaqësi, në kuptimin më të thellë të estetikës së kënaqësisë. Hapja e vetvetes kundrejt një përballeje të drejtpërdrejtë me Shekspirin në kulmin e fuqisë së tij krijuese, sikurse është Mbreti Lir, asnjëherë nuk është e lehtë, në të ri sikurse në pleqëri, dhe prapëseprapë të mos e lexosh në plotninë e vet Mbreti Lir (çka do të thotë pa kurrfarë manteli ideologjik) do të thotë të mashtrosh botërisht vetveten edhe në gjykim edhe estetikisht.

Një fëmijëri ku pjesën më të madhe të kohës e zë televizori domosdo shpie tek një adoleshencë ku kohën e gllabëron kompjuteri, dhe kësisoj

në dyert e univesitetit kemi një student që s'ka gjasa ta mirëpresë idenë se nevojitet durim në këtë rrugëtim që s'njeh fund deri në cakun e mbramë: urtinë që është gjithçka. Shmangia e këtij rrugëtimi e bjerr aftësinë e leximit, sikurse vetë univ bashkë me të. Keqardhja në këso rastesh s'ka kurrfarë vlere ashtu si zotimet e programet e paskëtajshme të leximit. Gjithçka ende mund të ndryshohet, mund të bëhet prej një lloj elite, gjë në fakt është e papranueshme, për shumë arsye, të mira e të këqija bashkë. Kjo ngase edhe sot ka akoma lexues vetmitarë, të rinj e të vjetër, kudo, madje edhe në universitete. Nëse kritika shërben për ndofarë gjëje ende në kohën tonë, shërben sepse i drejtohet këtij lexuesi, lexuesi që lexon për vetveten, dhe jo për interesa që me gjasë e tejkalojnë vetveten.

Vlera në letërsi sikurse në jetë, më së shumti ka të bëjë me të veçantën fshehatore, atë që kalon cakun e të zakonshmes, të tepërtën prej së cilës merr jetë kuptimi. Nuk është rastësi që historiografët – kritikët që besojnë se njerëzit janë produkt i historisë shoqërore – i shohin personazhet letrarë thjesht si gjurmë të lëna në letër, dhe kaq. Hamleti as që përbën një të vërtetë historike nëse mendimet që kemi nuk na përkasin ne. Kjo na sjell tek parimi i parë, që mund të përmirësojë mënyrën se si lexojmë sot, parim që ja detyroj Dr. Johnson-it: "Çliroje

mendjen prej klisheve" Fjalori të dëftën që klisheja është ligjërimit i stërfyrtë me banalitete të rëndomta, fjalori i stërfyrtësihëm si ai i një sektit a kultit shtriganësh.

Meqënëse universitetet kanë fuqizuar kulte të tilla si "gjinia dhe seksualiteti" dhe "multikulularizmi," qortimi i Johnson-it kësisoj shndërrohet në "çliroje mendjen nga kilshetë akademike." Një kulturë univesitare që vlerëson më shumë të brendshmet e femrave të periudhës viktoriane se sa vlerëson Robert Browning-un i ngjan një dalldie si ato që përshkruan Nathaniel West-i, gjë që tashmë është kthyer në as më shumë dhe as më pak se në standart. Produkt anësor i një "kulturë poetike" të këtyllë është fakti se nuk arrin të nxjerrë as edhe një Nathaniel West, dhe as nuk e degdis qoftë edhe ky fakt një kulturë akdemikë të allasojtë në zgripin e paradisë? Poemat e një mjedisi të kësoshëm akademik janë zëvendësuar nga të brendshmet e kulturës sonë. Materialistët tanë riosh na dëftojnë se i kanë kthyer trupin historiografisë, dhe shpallin se punojnë në emër të Parimit të Realitetit. Jeta e mendjes duhet të mposhtë vdekjen e trupit, por prapëseprapë kjo as që ka nevojë për bujën zulmëm madhe të një sektit akademik. Parimi i çlirimit të mendjes prej klisheve na shpie tek parimi i dytë i ringjalljes së leximit. Mos u orvat të bësh më të mirë fqinjin apo lagjen

lexojmë?



me atë që lexon apo si e lexon. Vetëpërmirësimi është një projekt aq madhor sa të mjafton vetja, mendja dhe shpirti yt: për to s'ka kurrfarë etike leximi. Mendja duhet mbajtur e përqendruar në shtëpinë tënde derisa padituria e saj e mirëfilltë të jetë zbuar me gjithsej; angazhimi i parakohshëm është magjepsës në vetvete, por merr shumë kohë, kohë e cila për leximin nuk do të jetë e mjaftueshme kurrë. Shkrimi për historinë, qoftë ajo e tashme apo e shkuar, është një lloj idhujtarie, adhurim i vazhdueshëm për çka ndodh në kohë. Lexo atëherë i udhëhequr prej dritës së brendshme që kremtonte Xhon Miltoni dhe që Emersoni e kishte parim të leximit, parim që fare mire mund të jetë parimi ynë i tretë: Studiuuesi është një qiri që ndizet gjithmonë prej dashurisë dhe gjakimeve të njerëzimit. Wallace Stevens-i, ndoshta duke e harruar autorin e tij, krijoi variante të mahnitshme të kësaj metafores, por fjalët burimore Emersoniane përbën një shprehje më të qartë të parimit të tretë të leximit. Nuk ka vend për drojen se liria e përmirësimit tënd si lexues përbën egoizëm, sepse nëse arrin të bëhesh lexues i mirëfilltë, atëherë fryti i mundimeve të tua do të shndërroj në një mendjendriçues për të tjerët.

U jam rikthyer shumë herë letrave që kam marrë prej njerëzish të panjohur tetë a nëntë vitet e fundit, dhe më ka ndodhur shpesh të prekem

aq shumë prej tyre sa të mos mundem t'u kthej përgjigje. Pathosi që i përshkon, për mendimin tim, përbën më së shumti një nevojë të thellë për studimin letrar profesionist, detyrim që universitet nuk begenisin ta përmbushin. Emersoni ka shkruar se shoqëria nuk bën dot pa njerëz të kultivuar dhe shtoi në mënyrë profetike se: "vatra e shkrimtarit nuk është shkolla, por njerëzimi." Ai e kishte fjalën për shkrimtarë të fuqishëm, burra dhe gra që mermin përsipër të ishin përfaqësues, përfaqësues të vetvetes, dhe jo kushtetutave, me të vetmen politikë atë që buron prej shpirtit njerëzor.

Funksioni më i lënë pas dore i edukimit universitar është nyjetuar përjetësisht në thirrjen e Emersonit drejtuar "Studiuesit amerikan", ku ai shpall se detyrat e studiuësit: "Mund të përmbledhen të gjitha tek vetëbesimi." Unë marr nga Emersoni edhe parimin e katërt të leximit: Që te lexosh mirë duhet të kesh shpirt krijues. "Leximin krijues" në kuptimin Emersonian e kam quajtur një herë "keqlexim," fjalë që i bindi kundërshtarët e mi se vuaja nga disleksia kronike. Humbëtira apo zbrazëti që ata shohin pas leximit të një poeme është pasojë e mospasjes së një shpirti të tillë krijues. Vetëbesimi nuk është dhunti, por Rilindja e Dytë e mendjes, e cila nuk mund të ndodhë pa vite të tëra leximi të pareshtur. Estetika nuk ka standarte absolute. Nëse ndokush mëton se fuqia shekspiriane është produkt i kolonializmit atëherë kush po e vriska mendjen të argumentoj të kundërtën? Pas katër shekujsh Shekspiri është më i fuqishëm se kurrë; dramet e tij do të luhen në hapësira jashtëtokësore, në të tjera botë, nëse këto botë do të arrihen. Ai nuk përbën përbetim për kulturën Perëndimore; por mishëron të gjitha parimet e leximit dhe është pika ime e referimit në këtë libër.

Borgesi ia mvishte këtë universalizëm mungesës së mirëfilltë të egoizmit të tij, cilësi që përbën një metaforë të shumëfishtë për dallimin mes Shakespear-it dhe të tjerëve, metaforë e fuqisë së tij njohëse si e tillë. Në lexojmë, më shpesh e më shumë se sa ne mendojmë se lexojmë, në kërkim të një mendjeje më origjinale se e jona. Ideologjia, sidomos në variantet me të cekëta të saj, është rënuesë sa i përket aftësisë së të kuptuarit dhe vlerësimit të ironisë, ngase unë sugjeroj që ringjallja e ironisë të jetë parimi ynë i pestë i ripërtëritjes së leximit.

Mendonin ironinë e pafundme të Hamlet-it, i cili kur thotë diçka nënkupton kryekrejt diçka tjetër, më së shumti krejt të kundërt me atë që thotë. Por, ky parim, sikur ma vret shpirtin, prejse s'ka gjasë t'i mësosh

dikujt të jetë ironik sikurse të bëhet lexues vetmitar. Prapëseprapë, humbja e ironisë shënon vdekjen e leximit, të asaj çka përbën qytetërim në mendjet tona.

*U qasa çap pas çapi fare lehtë
Ngadalë e mata udhën ca nga ca
Yjet mbi Krye flakëruan hatat
Nën këmbë kisha Detin vetë
S'dija se ç'ndillte tjetri hap
Mos vallë i fundmi asisoj –
Cakun e preka prapëseprap
Disa e quajnë "Përvojë"*

Të ecurit e burrave është e ndryshme nga e grave, me përrashim të rastit kur janë në kuadrate të disiplinuar marshimi, pasi ne të gjithë përpiqemi të ecim ndryshe nga të tjerët. Dickinson-i, mjeshtërja e Sublimes në zgrip, zor se mund të kuptohet nëse nuk ndiejmë shqisën e ironisë së saj. Ajo ecën përgjatë të vetmes udhë të mundshme, "çap pas çapi" por çapitja e saj e dalëngadaltë pranëvitet në mënyrë ironike me një titanizëm ku ajo ndien "Yjet mbi Krye," ndërkohë që ka detin nën këmbë. Duke mos e ditur nëse hapi tjetër i saj do të jetë "i fundmi asisoj" kjo i jep asaj atë mbërritje në atë cak të mbramë që ajo nuk do t'i vër emër, porse vetëm thotë që "disa" e quajnë Përvojë.

Ajo e kishte lexuar esenë e Emersonit "Përvoja", një punë e shkëlqyer në gjurmët e esesë "Mbi përvojën" shkruar prej mjeshtrit të saj Montaigne, dhe ironia e saj është një përgjigje e përkorë ndaj fjalëve hyrëse të Emersonit "Ku ta gjejmë vetveten? Një përgjigje kundërt një numri pyetjesh që nuk njohin cak, sepse besohet se ato nuk ekzistojnë." Caku për Dickinson-in është të mosditurit nëse tjetri hap është i fundmi asisoj. "Nëse ndokush prej nesh do ta dinte se si do ta kishim të shkuarën dhe cili është fati ynë i ardhshëm, atëherë kjo do të ishte kulmi i dijes!" Rugëtimi i mëpashtëm i Emersonit ndryshon nga ritmi i shtruar i Dickinsonit, sikurse e thotë ajo, "çap pas çapi". "Gjithçka rrjedh dhe shndrit," në mbretërinë e përvojës së Emersonit, dhe ironija e tij gjeniale është krejt ndryshe nga ironia e saj e nëndheshme. E megjithatë, asnjëri sosh nuk është ideolog dhe të dy mbijetojnë në kohë sajë fuqisë që mbartin ironinë e tyre të kundërta.

Në fund të shtegut të ironisë së humbur është caku i mbramë, përtej të cilit vlera e letërsisë do të jetë e parapërtërisht. Ironia është thjesht një metaforë, dhe rrallë ndodh që ironia e një epoke letrare të jetë si ajo e një epoke tjetër, sidomos qoftë, pa rilindjen e kuptimit të ironisë humbet shumë më shumë se ajo që ne e quajmë shkrim letrar. Tomas Mani, ndër më ironikët e

shkrimtarëve të këtij shekulli, duket se është bërë fir tashmë. Botohen biografi të reja të tij, dhe shkrimet për to mbështeten pothuajse gjithmonë vetëm në homoseksualitetin e tij, a thua se kësaj do mbahet gjallë interesi ynë si lexues për to, vetëm nëse vërtetohet se ishte homoseksual, dhe kjo t'i sigurojë një vend në bibliotekat tona. Nuk ndodh ndryshe as kur bëhet fjalë për Shekspirin, më së shumti përmendet biseksualiteti i tij i dalueshëm, dhe kësaj huqet e puritanëve të kohës sonë nuk kanë të sosur. Ironitë shekspiriane, sikurse dihet, janë më të shumëkuptimshme dhe dialektiket në tërë letërsinë perëndimore, dhe prapëseprap ato nuk ndërmjetësojnë gjithmonë pasionet e personazheve të tij për ne, kaq e gjerë dhe e fuqishme është furtuna e tyre emocionale. Kjo është arsyeja pse Shakespeare e tejkalon epokën tonë, edhe pse ironitë e tij shpërfillen për t'u marrë me vogëlsira.

Nga ana tjetër, në çdo emocion që ngjall Tomas Mani, rëfimor apo dramatik, ai ndërmjetësohet prej një estetike të ironisë; dhe ajo nuk mund t'u mësohet si e tillë e shembulluar tek librat Vdekje në Venecie ose Pështjellim dhe pikëllim i kahershëm pasi për shumë prej studentëve, qoftë edhe për më të talentuarit, është pothuajse e pamundur. Kur autorët rrenohen prej historisë, ne me të drejtë i shohim veprat e tyre si trakate periudhash historike, por kur ato nuk mbijetojnë për shkak të idelogjisë historike që i përshkon, mendoj se kemi të bëjmë me një dukuri tjetër. Ironia kërkon një vëmendje të caktuar, sikurse aftësinë për të ngjallur ide kundërtëne, edhe kur ato ndeshen me njëra-tjetrën. Po ti heqim ironinë leximit, i kemi hequr të befasishmen, gjithë të papriturën që na grish. Rrokni çfarëdo lloj libri që t'u zërë dora, një nga ata me vlera që gjykohen e peshohen, dhe keni për të parë se ka shumë gjasë që ironia do të jetë ajo që i jep vlerë e peshë, paçka se shumë prej mësuesve tuaj nuk e dinë se çfarë është apo se ku duhet kërkuar ajo. Ironia ta qëron mendjen prej klisheve ideologjike dhe të ndih të bësh dritë si qiri i studiuësit.

Tani po kaptoj të shtatëdhjetat, dhe në këtë moshë njeriu nuk para ka qejf të lexojë letërsi të dobët sikurse të shohë ditë të zeza, përderisa ditët i kemi të numëruara. Nuk e di nëse vdekjen ia kemi borxh Zotit a natyrës, por natyra do të bëjë të vetën, dhe ne pa më të voglin dyshim mediokritetit nuk i kemi kurrfarë borxhi, pavarësisht se çfarë turme nënkupton apo përfaqëson ai. Ngase lexuesi im ideal, për një gjysmë shekullia, ka qenë Dr. Samuel Johnson-i, po sjell fragmentin tim të parapëlqyer shkëputur nga parathënia e tij për Shakespeare-in:

Kjo pra është fuqia e Shakespeare-it, drama e tij është pasqyrë e jetës; kushdo që kuturis në mbretërinë e imagjinatës për të rendur pas shajnive që të tjerë shkrimtarë para tij krijuan, mund të gjej tek ai ilačin shërues për dallitë e tij delirante ngase lexon aty ndenjat njerëzore në gjuhë njerëzore, prej skenash me anë të cilave një eremit mund të


shkoqisë punët e botës dhe një pendestar shtigjet e pasioneve të saj."

Që të lexosh ndjenjat njerëzore në gjuhën me të cilën shprehen, duhet të dish të kuptosh gjuhën njerëzore, në plotninë e saj. Kështu ti i tejkalon ideologjitë, pavarësisht nga bindjet vetjake që mund të kesh, dhe Shakespeare shfaqet para teje, sipas aftësisë që zotëron për ta zbuluar atë. Kjo do të thotë se Shakespeare të lexon më katërcipërisht se sa mund ta lexosh ti atë, edhe kur ta kesh qeruar mendjen nga klishtë. Asnjë shkrimtar para tij apo prej Shakespeare-it e më pas ka arritur të zotëroj si ai aftësinë e krijimit të thellësisë dhe larmisë së dritëhijeve të personazheve, pikëvështrime që tejkalojnë çdo lloj kontekstualizmi që u paracaktohet dramave. Johnson-i, duke e pikasur fort mirë këtë, na nxit ta lexojmë Shakespearin që të na çlirojë nga "dalldisjet delirante." "Lejomëni ta shtjelloj më tej këshillën e Johnson-it i cili na nxit gjithashtu që të pranohet djaljtë që dëbon leximi i thellë i Shekspirin. Njëri sosh është Vdekja e Autorit; një tjetër është pohimi që vetvetja është trillim; dhe tjetri në radhë është ai sipas të cilit personazhet letrarë e dramatikë janë thjesht shenja të shumta të lëna në letër. Djalli i katërt dhe më i kobshmi është mendimi se gjuha është ajo që përcakton mendimin tonë.

Sërish, dashuria ime për Johnsonin, dhe për leximin, më shtyn të shmang polemikat, e në vend të tyre të lartësoj shumë prej lexuesve vetmitarë që takoj vazhdimisht, qoftë në auditore apo në letrat që më dërgojnë. Në lexojmë Shakespearin, Danten, Chaucer-in, Servantin, Dikensin, Prustin, dhe të gjithë të ngjashmit e tyre sepse ata i zgjerojnë përmasat e kuptimit të jetës. Praktikisht, ata përbëjnë Bekim, në kuptimin e vet më hyjnor me "më shumë jetë në një kohë që s'ka kufij." Në lexojmë pafundësisht për shumë arsye, disa prej tyre të ditura: ngase s'mund ti njohim plotësisht njerëzit, t'i njohim aq sa të mos ketë më nevojë: ngase kemi nevojë të njohim më mirë veten; ngase kemi nevojë për dijen jo vetëm në lidhje me veten dhe të tjerët, por edhe se si janë punët e kësaj bote.

Prapëseprapë, motivi më i fuqishëm dhe themelor për një lexim të thellë të veprave tradicionale klasike jo pak të nëpërkëmbura, është gjurmimi i ëndjes së mundimshme. Afërmendsh që nuk jam nxitës i leximeve erotike, por ëndja e mundimshme mua më duket përkufizimi më i mirë i Madhështores në letërsi, edhe pse kjo ëndje e epërme mbetet kërkimi i pareshtur i lexuesit. Eziston pra, Madhështimi i lexuesit, dhe duket të jetë i vetmi tejkallim i kufijve normal të ekzistencës që mund të arrijmë ndonjëherë, me përjashtim të rastit më skajshëm që ne e quajmë "të rënit në dashuri." Ju bëj thirrje të lexoni çka i përshtatet shpirtit tuaj, çka i jep peshë mendimit dhe gjykimit. Lexoni thellësisht, jo për të besuar, as për të pranuar, as për të kundërshtuar, porse për të mësuar të njësoheni me atë natyrë si e juaja që edhe shkruan edhe lexon. /Gazeta "ExLibris"/

At Gjeçovi Kryeziu: Mos ma



Vet Gjeçovi në vitet e fundit të jetës së tij na jep disa sqarime për origjinën e emrit të fshatit Kryezi të rrethit të Pukës.

Ndryshimi i mbiemrit të tij kishte të bënte me një traditë të vjetër kishtarë që e shpjegon Rrok Zojzi në monografinë e vet.

Një fjalë e urtë e popullit e trashëguar brez pas brezi dhe shekull pas shekulli thotë: "Amanetin nuk e tretë as dheu". Të heshtim "NE" për ato që vetë At Shtjefën Gjeçovi ka thënë me shpirtin dhe mendjen e vetë, dhe duke lënë të shkruar me doren e vet është pabesi që i bëhet ashtu siç e vranë në pabesi.

Ne nuk duhet ta vrasim për së dyti me heshtjen tonë por as të ndryshojmë ato që ka lënë vet të shkruara dhe as ato që kanë shkruar të tjeret për të. At Gjeçovi ishte dhe mbetet tempull më vete që ndriçon pa ndërprerë brez pas brezi. Ai ishte dhe mbetet një njeri i madh dhe burrë-shtetas i ditur. Ja si

shkruan At Gjeçovi në shkrimin e tij: "Koha e Zgjetave" (Koha e shigjetave).

Duke shkruar në Shkodër i pari i Thaçit më emrin e vetë "THAÇ" në Vaun e Dëjes (Deja) takon një djalosh që ishte vetëm dhe nuk dinte së ku po shkonte. Kur pa të parin e Thaçit mbi kalë shale e pyeti se për ku ishte nisë të shkonte. I pari i Thaçit ju përgjigj në Shkodër më vulos disa gjyge dhe pleqëni që bëheshin prej të parve të secilës krahinë në Shkodër përpara Krye-zotit. Më merr me veti i tha djali sa me të mbajtë kalin mbasi nuk kam njeri dhe jam i varfër.

I pari i Thaçit pasi e pyeti së nga ishte, ky i tregoj së kishte dalë

nga fshati i "KOLONJES". E mori më veti dhe shkuan në Shkodër. I pari i Thaçit pasi pat shkruar disa herë me të Kolonjasin (por tani i lodhur nga pleqëria) e burrat e vllazënisë së Thaçit rreth 50-60 veta por jo në nivelin e duhur për të përfaqësuar në pleqëri dhe gjyge. Prandaj i pari i Thaçit shkoj edhe një herë në Shkodër më kolonjarin dhe mbasi i vulosi pleqënit e gjyget së bashku më pleqët e tjerë i kerkoj Krye-zotit të Shkodërs që ti jepte leje me dërgue kolonjarin me vulë të flamurit e të vendoste emrin e atij në gjyge e pleqni që do të bëheshin përpara atij, sepse vetë nuk mund të levizte nga mosha lart e poshtë.

ndryshoni genin



ka qenë i banuar me Thaç.

Biseda e At Gjeçovit në kolegjin e Troshanit me një prift

Në vitin 1928 me 13 janar At Sh. Gjeçovi-Kryeziu tregon: Më bije në mend kur isha fëmijë në shtëpi e kur ndonjeni nga ne ishte i idhët(kokë fortë) e kryeneç plaku Pepa(Petar)Gjeçovi i bërtiste duke i thënë: "Ah Kryezi breh!". Ja biseda e At Gjeçovit në kolegjin e Troshanit me një prift të shkollës. Si të quajnë e pyeti burri me veladon?. Hilë i tha shkurt djaloshi. Hilë kush? E pyeti po ai zë. Hilë Gjeçi ju përgjigj djaloshi. Nga je?Nga Janjeva e Kosovës. Si ta quajnë babën?. Mat, Mat Gjeçi. Ai më ka thënë së të parët tanë janë nga Kryeziu i rrethit të Pukës. Gjeçi e kanë quajtur të parin e fisit tonë. Në Janjevë prindrit e Gjeçovit, gjyshi apo ndoshta stergjyshi kishin ardhur përpara shumë vitesh.

Ata u detyruan të largohen nga malësitë e Pukës për të siguruar kushte më të mira jetesë. Për një kohë të gjatë ata ruajtën mbiemrin "Kryeziu" për të treguar fshatin e lindjes, por pastaj filluan të mbiemroheshin më emrin e të parit të familjes apo të fisit të tyre "GJEÇI". Gjeçovi shumë vjet më vonë fjalën "Kryezi" do ta përdorë përsëri si mbiemër të vet, dhe vitet e fundit, kur jetoi e punoi në Kosovë do të shkruaj diçka më tepër. Vet Gjeçovi në vitet e fundit të jetës së tij na jep disa sqarime për origjinën e emrit të fshatit Kryezi të rrethit të Pukës, për të cilin folëm më sipër.

Ndryshimi i emrit kishte të bënte me një traditë të vjetër kishtarë që e shpjegon Rrok Zojzi në monografinë e vet."Kur një njeri, pranohej pjestar i urdhërit françeskan duhej të ndërronte emrin e të merrte një emër të ri për të treguar kështu se shkëputej nga jeta e më parëshme, nga lidhjet fare fisnore, nga e drejta e trashëgimisë, e pronës etj. Sipas kësaj traditë edhe emri i Mëhill Gjeçit u shëndrrua në Shtefën Kostandin Gjeçov. Ruzhdi Mata-Gjeçovi Nderi i Kombit Tiranë,Reklama 2000,f.5-10.Na duket me rëndësi që etnografi ynë, pas llagapit (mbiemrit) Gjeçov, shënon "Kryeziu".

Ndre Mjeda më 1935 shkruante se arqipeshkvi i Shkupit Carev dhe fretërit Shishkoviç e Brkiç përhapen sa mundën gjuhën sllavene me anë të predikimit e të shkollës jo vetëm në Janjevë,ku humbi gjuha

shqipe,por edhe në Prizren, Shkup, Letnicë e Gjakovë. Shtjefën Gjeçovi i përkiste vëllezërisë Përgjeçaj (Prend Gjeçi) të Janjevës,një degë e fisit të vjetër Kryezez,mjaft i përhapur në Kosovë, Pukë, Lezhë etj. Autoritet fetare e regjistruan në shkollë me llagapin (mbiemrin) Gjeçoviç. Kur ai u bë i vetëdijshëm për këtë falsifikim,nuk qe në gjendje të bënte më tepër, veç të hiqte atë-ic e të mbetej Gjeçov. Këmbëngulja e Shtjefën Gjeçovit për të përdorë llagapin (mbiemrin) Kryeziu, që e shohim në disa dorëshkrime si edhe në kokën e shkropit që e mbajti në dorë deri ditën e vrasjes, tregon shqetësimin e tij për të çuar në vend një të vërtetë, që ka të bëjë me kombësinë e tij thjesht shqiptare.

Kahreman Ulqini.-Dy dorëshkrime të Shtefën Gjeçovit-Kryeziut,Etnografia shqiptare nr.10, viti 1981 f.244. Prejardhja e Gjeçovit trajtohet te"Koha e zgjetave" (koha e shigjetave) në vol.Gjeçovi-VEPRA.3 Rilindja-Prishtinë 1985. f. 261. Në vitin 1935 në revistën "Hylli i Dritës" ku Dom. Ndre Mjeda shkruan për Fulgens Carev O.F.M.në Dioqezën e Shkupit thotë se: "Kazarev (Carev) ishte ai që i dha shkas përhapjes së gjuhës Sebo-Kroatishte në Janjevë".Për veç gjuhës ata përdorën dhe liturgjinë sllave nëpërmjet dy Boshnjakve, ish fratit Shishkoviç dhe me ndonjë mësues shkolle të atij katundi e të At. Frano Brkiç. Po këtu mes të tjerave edhe disa fretenve në shqiperi që për emen vllazënije kishte Pergjeçaj(Prend Gjeçi) i ju zevendsua me Gjeçoviç e Gjeçov.Pra Përgjeçaj (Prend Gjeçi) para ardhësit i Gjeçovit ketë mbiemër e kishte dhe në Janjevë. Dom.Ndre Mjeda:Hylli I Dritës.viti 1935 nr.1 f.33-37.

Në një studim për fisin e Thaçit Paulin Zefi (Historian. Drejtor i Sektorit të Trashëgimisë Kulturore) pranë Bashkisë -Lezhë shkruan se Prendi gezon atributet e stergjyshit të pinjollëve më të shquar të fisit Thaç ku bëjnë pjesë edhe para ardhësit e të madhit Fishta. Po në të njëjtin material të studimit historik për fisin e Thaçit shkruan:"Kujtojmë së At. Shtjefën Gjeçovi mbiemrin e tij të vertetë e kishte Gjeçi dhe emrin Mëhill. Pra Mëhill Gjeçi.Pak më lart Dom.Ndre Mjeda thotë së nga Përgjeçaj (Përend Gjeçaj) serbo-sllavet e tjetersuan në Gjeçoviç dhe Gjeçov.Duke u bazuar në dokumentet e më sipërme vërtetohet së edhe At.Shtjefën Gjeçovi

është fis Thaçi i vllazënisë Prend Gjeçi të Iballës së Pukës, por dihet së kjo vllazëri e fisit Thaç ka jetuar edhe në Kryezi. Pra At.Shtjefën Gjeçovi dhe At. Gjergj Fishta janë kushëri të një gjaku nga baba të vllazërisë Prend Gjeçi më qënder në Iballë-Pukë. Duhet ta theksojmë se në fiset e veriut ishte traditë ruajtja e afërsisë së gjakut në breza si nga baba ashtu dhe nga nëna.Kështu që At.Gjergj Fishta dhe At.Shtjefën Gjeçovi ishin dajat e Dom. Ndre Mjedës nga nënapor është burrë Kryeziu (i biri i Kolë Zefit,Kryeziut dhe Luke Thaçit të Iballës).Pra Dom Ndre Mjeda e dinte shumë mirë origjinën e Gjeçovit se ishte nga vllazënia e Prend Gjeçit të Thaçit Iballës. Çdo manipulim i huaj apo vendas nuk u shërben dimensioneve të këtyre kollosve të kulturës dhe patriotizmit mbarë kombëtar shqiptar për kundraz i dëmton të vërtetat për këto figura. At Gjeçovi lindi në Janjevë më 12 korrik 1874 ku mbaroj 3(tre) vite shkollë. Në kolegjin françeskan në Shkodër ku u paraqiti e dërguan në kolegjin françeskan në Trashan të Lezhës për të vazhduar mesimet ku dhe i mbaroj. Në vitin 1888 vazhdoi studimet në Bosnjë dhe Kroaci(këtu studio për teologji dhe filozofi).Shërbeu si famullitar në Laç të Kurbinit, Troshan,Gomsiqe e Gojan, Theth, Shalë e Shosh por shërbeu dhe në Pejë, Gjakovë e Prizren si dhe në Shkodër,Durrës,Vlorë dhe Zarë në Kroaci. Ai ishte patriot(pjesëmarrës në luftën e Vlorës në vitin 1920) shkrimtar, etnolog dhe arkeolog, përk e t h y e s ,klerik,dramaturg,mësues i popullit ,novelist, përhapës i aresimit shqip. Kanuni mbetet kryevepra e tij. Laurimet:1.At Shtjefën Gjeçovi është nderuar me "Medalja e Artë e Lidhjes së Prizrenit" në Kosovë. 2."Monument i At Shtjefën Gjeçovit".Për veprimtarinë e tij etnografike dhe arkeologjike brenda dhe jashtë atdheut Universiteti i Lajpcigut të Gjermanisë i dha titullin"Doctor Honoris Cauza". Në Shqipëri për veprimtarinë e tij patrotike dekorohet më urdherin "Naim Frashëri" të klasit të parë.(E.E.SH.) Tiranë 2008,f.814. Më 14 tetor 1929 në Zym të Kosovës nga një atentat serbo-sllav At Gjeçovi vritet. Në të vërtetë ai ndërroj jetë por se,veprimtaria e tij patriotike,dashuria për atdhe , për pamvarësi, për shkollim, dije dhe kulturë, studimet e tij bashkëkohore dhe në lashtësi e bejnë"TEMPULL"në vete që nuk e lënë të vdesi kurrë. /shqiptarja/

Kerkesa e të parit të Thaçit u pranua nga Krye-zoti i Shkdrës dhe që nga ky moment filloj kolonjari të bënte lidhjen Thaç-Shkodër për të gjitha gjyget dhe pleqnitë te Kryezoti i Shkodrës. Pasi u bë kolonjari si i shtëpisë në vllazëninë e Thaçit kërkoj të fejohej më të bijen e Thaçit. Pasi u keshillua i pari Thaçit më njerzit e shtëpisë ranë në një mendje(dakort) me ja dhanë kolonjarit vajzën e vetme që kishte në shtëpi.

Pasi u martua kolonjari pas 3 vjetësh Thaçi (i pari i Thaçit vdes) kurse kolonjari vazhdonte rrugën si më përpara pa i kerkuar kush as arsye as vullë.Këtij i linden 3 djem.

Sipas At Gjeçovit, Emni "Kryezi"i mbeti katundit prej emnit të të birit të kolonjarit i cili kishte qënë shumë i idhet (kokë fortë).Si zuni vend në Kryezi ky u ba më Kabash, e kështu i mbeti vula në dorë Kryeziut, (mbasi nuk u interesuan thaçjanët) pra i mbeti pleqnia në dorë.Prandaj mbeti fjala "Kryeziu pleqnusja" e Kabashit.

Pra, vula e gjygeve dhe pleqnive ishte eThaçit, por që i mbeti në dorë Kolonjarit (dhëndërrit të Thaçit) pas vdekjes së Krye-pleqnuesit të Thaçit, sepse nuk u interesuan pasadhësit e Thaçit për vullen e fisit. Pra për sa u tha arrihet në përfundimin se: fshat i Kryeziut

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Gjilani nuk i ndahet Ballkanit, Drita befasohet nga Flamurtari

Nga katër ndeshjet e fundjavës në Superligë, fituese dolën katër skuadra vendëse, një skuadër mysafire dhe një ndeshje përfundoi pa fituese. Lidere vazhdon të jetë skuadra e Ballkanit nga Suhareka, kurse me humbje debutoi trajneri Agim Sopi, e me barazim Severin Elezaj



EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Java e trembëdhjetë në IPKO Superligën e Kosovës në futboll ka qenë shumë interesante pasi nuk kanë munguar befasitë. Të dielën skuadra e Gjilanit e tregoi superioritetin ndaj Ferizajt për herë të dytë në këtë edicion derisa e mposhti 4-0.

Fiton Hajdari ishte i pandalshëm në këtë ndeshje sepse shënoi tri gola në portën e portierit mysafir. Një gol për skuadrën e Gjilanit e shtoi Tomislav Busiq. Pas këtyre tri pikëve skuadra e drejtuar nga strategu Gentian Mezani ngritët në pozitën e dytë me 27 pikë, e në anën tjetër Ferizaj është i parafundit me 9 pikë.

Skuadra e Bekim Isufit, ani pse të premten ua ka dhënë pagat futbollistëve, nuk ka arritur të tregojë lojë të mirë dhe t'i shmangët humbjes. Befasi në rezultat final ishte edhe fitorja e Flamurtarit në përballje me Dritën (1-0). Në pjesën e parë Drita kishte disa raste shënimi, por goditja e Vucajt nga gjuajtja e lirë përfundoi në shtyllë, kurse të saktë nuk u treguan as Namani dhe Shabani. Në anën tjetër Islami pati rast të mirë për vendësit, por që nuk e shndërroi në gol. Edhe në pjesën e dytë rastet nuk munguan, kurse vetëm një prej tyre u shfrytëzua nga Torviol Stullqaku, i cili realizoi për 1-0 në minutën e 78. Pas kësaj fitore Flamurtari ngritët në kuotën e 12 pikëve dhe zë vendin e nëntë, kurse Drita bën një hap pas në garë për kreun e tabelës, derisa tash zë vendin e tretë me 24 pikë. Tri ndeshje të tjera janë zhvilluar të shtunën, kurse Ballkani e ka vazhduar shkëlqimin edhe në Drenas.

Liderët e elitës e kanë mposhtur

skuadrën kampione në fuqi, Feronikelin (0-2). Dy golat për skuadrën nga Suhareka i shënoi sulmuesi i ri Blend Baftiu, kurse me humbje debutoi trajneri i ri i "Niklit", Agim Sopi. Ballkani i Ismet Munishit ka 29 pikë dhe e mban kryesimin, kurse Feronikeli është dhjetë pikë pas kësaj skuadre dhe renditet në pozitën e gjashtë. Në xhiron e radhës Ballkani e pret Llapin, ndërsa Feronikeli i shkon Prishtinës. Ndërsa në ndeshjen e zhvilluar në Klinë, Dukagjini e ka ndaluar Prishtinën në barazim 0-0. Pavarësisht prej dominimit, skuadra kryeqytetase nuk arriti me shumë se një pikë. Vlen të ceket se në këtë ndeshje Dukagjini u drejtua nga trajneri i rikthyer në skuadër, Severin Elezaj.

Në ndeshjen tjetër Trepça '89 - Vushtrria fituese doli skuadra nga Mitrovica me rezultat 1-0. Golin e vetëm në "Riza Lusha" e realizoi Arb Manaj.

Liria barazon me Vëllaznimin, por kryeson në Ligën e Parë

Janë zhvilluar ndeshjet e xhiros së dymbëdhjetë në Ligën e Parë të Kosovës në futboll. Dy rivalët e vjetër, Lira dhe Vëllaznimi, kanë ndarë pikët pasi në Prizren kanë luajtur baras 1-1. Pavarësisht prej këtij barazimi, skuadra e Lirisë vazhdon të jetë lidere, kurse e dyta në tabelë është skuadra e Malishevës, e cila po befason me rezultate pozitive. Në ndeshjen e fundit kjo skuadër e ka mposhtur Ramiz Sadikun me rezultat 0-3. Besa e Pejës ka dështuar në përballje me 2 Korrikun (1-0), kurse fitoren më të thellë në këtë xhiro e regjistroi Onizi ndaj Vllaznisë (7-0).

IPKO SUPERLIGA

Gjilani - Ferizaj	4-0
Flamurtari - Drita	1-0
Trepça '89 - Vushtrria	1-0
Feronikeli - Ballkani	0-2
Dukagjini - Prishtina	0-0
Llapi - Drenica	1-0

Tabela

1. Ballkani	13	29 pikë
2. Gjilani	13	27
3. Drita	13	24
4. Prishtina	13	24
5. Llapi	13	23
6. Feronikeli	13	19
7. Trepça '89	13	19
8. Drenica	13	17
9. Flamurtari	13	12
10. Vushtrria	13	9
11. Ferizaj	13	9
12. Dukagjini	13	8

Në xhiron e radhës takohen: Ballkani-Llapi, Drenica-Trepça '89, Drita-Dukagjini, Prishtina-Feronikeli, Ferizaj-Flamurtari, Vushtrria-Gjilani.

LIGA E PARË

Onix - Vllaznia	7-0
Drenasi - KEK-u	1-3
2 Korriku - Besa	1-0
Trepça - Dardana	1-2
Istogu - Arbëria	0-2
Liria - Vëllaznimi	1-1
Ramiz Sadiku - Malisheva	0-3
Ulpiana - Vitia	0-0

Tabela

1. Liria	12	22 pikë
2. Malisheva	12	22
3. Arbëria	12	22
4. Istogu	12	21
5. Dardana	12	19
6. Besa	12	18
7. Trepça	12	18
8. Onix	12	16
9. Drenasi	12	16
10. KEK-u	12	16
11. Vllaznia	12	16
12. 2 Korriku	12	13
13. Ulpiana	12	13
14. Ramiz Sadiku	12	11
15. Vitia	12	10
16. Vëllaznimi	12	6

SHKURT

Rashica sërish shënon për Bremenin

Reprezentuesi i Kosovës në futboll, Milot Rashica, ka vazhduar formën e mirë, pasi ka shënuar sërish për skuadrën e Werder Bremenit, e cila luajti baras me Friburgun (2-2). Rashica e ka shënuar golin e parë për Bremenin, kurse golin e dytë e realizoi Theo Gebre Selassie.

Bashkimi fiton derbin ndaj Prishtinës

Bashkimi ka arritur një fitore të madhe ndaj Sigal Prishtinës me rezultat 95-89. Ndeshja ka qenë shumë interesante, derisa vendësit e nisën më mirë ndeshjen, duke e fituar çerekun e parë 22-13. Perioda e dytë ishte më e balancuar, derisa prizrenasit shkojnë në pushim me rezultat 47-41. Lojë e barabartë u zhvillua edhe në periudhën e tretë, derisa rezultati në semafor pas 30 minutash tregonte shifrat 72-67. Bashkimi arriti ta ruajë epërsinë edhe në dhjetëminutëshin e fundit dhe në fund fiton me rezultat 95-89. Më të merituarit për këtë fitore të Bashkimit ishin Stevie Clark me 35 pikë, Corey Ross me 22 dhe Terik Bridgeman me 16, kurse te skuadra prishtinase u dalluan Divine Myles me 21 pikë, Fahro Alihoxhiq me 20 dhe Edmond Azemi me 18.

Trepça e Kastrioti me fitore të reja

Trepça ka vazhduar me fitore në Superligën e Kosovës në hendboll. Në kuadër të javës së shtatë mitrovicasit shënuan fitore të vështirë ndaj Drenicës në Drenas me vetëm një gol dallim, 24-23. Cimili me 9 gola ishte më efikas te Trepça, kurse te Drenica u dalluan Kastrioti e Zekaj me nga 6 gola. Kastrioti i Ferizajt ka fituar kundër Llapit me rezultat bindës, 46-29. Dugolli dhe Shabani shënuan nga 9 gola për ferizajasit. Te Llapi Havolli e Hoxha kishin nga 7 gola të shënuar.

Triumf madhështor i Shkëndijës ndaj Borecit

Shkëndija e Tetovës ka triumfuar me poker ndaj Borecit, me kuqezinjtë që zgjidhën gjithçka në pjesën e parë. Të besuarit e Ernest Gjokës me sa duket kanë gjetur ritmin e duhur tashmë dhe pas triumfit në kupë ndaj Vardarit, marrin një fitore me goleadë ndaj Borecit. Alimi ishte njeriu i ndeshjes, me këtë të fundit që shënoi tri herë, ndërsa emrin në listën e golshënuesve e vuri edhe Besart Ibraimi. Kjo ishte fitorja e pestë sezonale për Shkëndijën, që ngjitet në vendin e tretë në kuotën e 18 pikëve. Nga ana tjetër, Vardari fitoi 2-0 ndaj Renovës, duke konsoliduar pozitën në kreun e renditjes me 30 pikë. Shkupi u nda në barazim në përballjen me Strugën me sfidën që u mbyll me shifrat 0-0.

Vinalesi triumfon në Malajzi, Marquezi thyen rekordin historik

KUALA LUMPUR, 3 NËNTOR - Kampioni i botës në Moto GP, Marc Marquez, nuk arriti të fitonte në pistën e Malajzisë, pasi u rendit i dyti dhe vendi i parë shkoi për Maverick

Vinales, por sërish bëri një garë madhështore. Marquezi u nis nga vendi i 11-të, pasi u rrëzua në provat e lira dhe fitoi nëntë pozicione gjatë garës duke u ngjitur në podi-

um. Ai vendosi rekord për pikët e grumbulluara brenda një sezoni, pasi tani numëron 395 pikë. Vinales zhvilloi një garë të përkryer dhe fitoi me meritë të plotë. Vendi i tretë

në podium shkoi për Andrea Dovizioso, ndërsa "Doktori" Valentino Rossi zhvilloi një garë pozitive. Ai u rendit i katërti duke marrë një rezultat të mirë.



Daku ia sjell fitoren Kukësit



KUKËS, 3 NËNTOR - Ekipi i Shpëtim Duros, Kukësi, e ka ftuar me rezultatin 1-0 ndeshjen ndaj Flamurtarit. Skuadra verilindore nuk bindi, madje mund të kishte humbur, nëse Xhika nuk do të ishte kthyer në "hero". Pjesa e parë nuk dhuroi shumë emocione me të dy ekipet që

nuk sulmuan me forca të shumta. Niveli i lojës nuk ishte më i miri dhe të dy ekipet shkuan në dhomat e zhveshjes me rezultatin 0-0. Pjesa e dytë nisi mirë për verilindorët. Sulmuesi Marllind Daku kaloi Kukësin në avantazh në minutën e 57. I ri mori një top të mirë në shtyllën

e dytë dhe e dërgoi në rrjetë. Flamurtari reagoi me Sukajn në dy çaste, por Xhika bëri mrekullinë. Hoxhaj goditi traversën, por sërish vlonjatet dolën pa pikë nga kjo sfidë. Kukësi kap vendin e parë me 18 pikë, ndërsa vlonjatët mbeten në fund të tabelës.

Toronto mposhtet nga Milwaukee

MILWAUKEE, 3 NËNTOR - Ndeshje të zjarrta janë zhvilluar në elitën e basketbollit amerikan NBA. Kampioni në fuqi i NBA-së, Toronto Raptors, ka pësuar edhe humbjen e dytë këtë edicion, ku është mposhtur nga Milwaukee Bucks me 10 pikë diferencë 115-105. Giannis Antetokounmpo me 36 pikë, 15 kërcime e tetë asistime ishte më meritori për fitoren e Bucksit. Derisa me lojë të mirë u dallua edhe Eric Bledsoe me 14 pikë, e Brook Lopez e Kris Middleton shtuan nga 11 të tjera. Kyle Lowry ishte më efikas te kanadezët me 36 pikë të shënuara, por që nuk mjaftuan për fitore. Ndeshje e zjarrtë është zhvilluar edhe në Moda Centër të Portlandit, ku Philadelphia 76ers ka marrë fitore në sekondën e fundit ndaj Portland Trail Blazers me rezultat 129-128. Turku Korkmaz realizoi treshe një sekondë para fundit të takimit për t'i dhënë fitoren e pestë këtë edicion Philadelphia. Në fakt, te 76ers gjashtë basketbollistë realizuan pikë dyshifrore, derisa më efikas ishte Al



Horford me 25 pikë, pesë kërcime e shtatë asistime. Damien Lillard shënoi 33 pikë

për vendësit, por që në fund nuk ishin të mjaftueshme për fitoren e katërt në NBA.

REZULTATET

Oklahoma City - New Orleans	115-104
Detroit Pistons - Brooklyn Nets	113-109
Orlando Magic - Denver Nuggets	87-91
Memphis Grizzlies - Phoenix Suns	105-114
Milwaukee Bucks - Toronto Raptors	115-105
Washington Wizards - Minnesota Timberwolves	109-131
Golden State Warriors - Charlotte Hornets	87-93
Portland Trail Blazers - Philadelphia 76ers	128-129

SHKURT

Roma nis bisedimet për transferimin e Hysajt

Roma dhe Napoli kanë filluar bisedimet për transferimin e mbrojtësit shqiptar Elseid Hysaj në "Olimpico". Roma është duke u interesuar për Hysajn, pasi po ka probleme në krahun e djathtë të mbrojtjes. Në anën tjetër Hysaj nuk po ka hapësira te Napoli i Carlo Ancelottit dhe ka kërkuar largimin. Por problemi më i madh mbetet te çmimi i tij, pasi Roma nuk është gati të ofrojë më shumë se 12 milionë euro. Ndërkohë Napoli nuk zbrit nga kërkesat e saj që kërkon 20 milionë euro për shkodranin.

Valverde nuk mendon për dorëheqje

Barcelona pësoi humbje të shtunën nga Levante (3-1), por Ernesto Valverde nuk e ka ndërmend të japë dorëheqje. "Sigurisht se nuk po mendoj për këtë, është vetëm një humbje. Duhet të reagojmë, e bëjmë gjithmonë këtë dhe nuk do të jetë më ndryshe këtë herë. Qëllimi ynë ishte të përpiqemi dhe ta arrinim golin e dytë, pasi morën epërsinë, por s'ishim në gjendje të rrezikonim mjaftueshëm. Na mungoi organizimi në pjesën e dytë dhe kishim pak kontroll në lojë", ka thënë Valverde.

Handanoviç: Me Dortmundin nuk do të jetë një ndeshje e lehtë

Në mesjavë Interi do të ketë një tjetër ndeshje të rëndësishme siç është ajo me Borussia Dortmundin në Ligën e Kampionëve. Portieri "zikaltër", Samir Handanoviç, është shprehur se ndeshja me ekipin gjerman do të jetë shumë e vështirë dhe se ata duhet të punojnë çdo ditë. "Të martën nuk do të jetë një ndeshje e lehtë ndaj Dortmundit. Ne dimë se ata në shtëpi janë një ekip i shkëlqyer. Të gjitha ndeshjet në Ligën e Kampionëve janë vendimtare", ka thënë Handanoviç.

Lëndohet Suarez, humb dy ndeshjet e radhës


Skuadra e Barcelonës, përveç humbjes nga Levante të shtunën, mori edhe një lajm tjetër të keq. Sulmuesi Luis Suarez, i cili u largua nga fusha në fund të pjesës së parë, do të mungojë në dy ndeshjet e radhës. Sulmuesi uruguian fillimisht mungon në përballjen e Ligës së Kampionëve ndaj Slavias së Pragës e më pas në La Liga kundër Celta Vigos.

Kovaqi: Nuk mund të them asgjë për të ardhmen

Bayern Munchen pësoi humbje befasuese nga Eintracht Frankfurt (5-1). Pas kësaj humbje tifozë të shumtë të skuadrës "bavareze" janë duke kërkuar shkarkimin e trajnerit kroat Niko Kovaq, i cili ka thënë se nuk është duke menduar largimin nga kampionët e Gjermanisë. "Nuk mund të them asgjë për të ardhmen time. Ajo çfarë mendoj unë nuk ka shumë rëndësi në këto çaste. Ju (gazetarët) duhet të pyesni ata persona që janë përgjegjës për emërimin e trajnerëve, jo mua", ka thënë Kovaq.

Arsenali e sheh Mourinon si zëvendësues të Emerys

Unai Emery mund t'i ketë të numëruara ditët në Arsenal, pasi drejtuesit e klubit janë takuar me trajnerin portugez, Jose Mourinho, sipas gazetës britanike "The Times". Mourinho është takuar me drejtorin sportiv të Arsenalit, Raul Sanhelli, për të biseduar për mundësinë që portugezi ta marrë drejtimin e klubit londinez. Sipas "The Times", Mourinho dhe Sanhelli u takuan ditë më parë në një restorant ku darkuan dhe biseduan gjatë. Arsenali nuk është plotësisht i bindur nga metoda dhe stili i lojës së Emeryt, prandaj po mendon seriozisht ta shkarkojë atë nga posti i trajnerit. Trajnerit spanjoll madje i është dhënë ultimatum. Gazeta britanike shkruan se ai do t'i ketë edhe dy ndeshje në dispozicion për ta ndryshuar situatën në Arsenal. Nëse edhe pas tyre nuk e bind bordin, atëherë ai do të shkarkohet. Me Mourinon në radhë për ta zëvendësuar.

Autor: GAZMEND MORINA	KËNGËTARJA & AKTORJA NË FOTO 2	ANIJATË; PJESE E BRENDSHME E NJË KISHE (shq.)	UDHËHEQËS I NJË FAKULTETI MËNDESHË, TAJË	TRAJNERI HOLLANDEZ ... HAN	TAKSË	ZANORE	RENS ISTVUD	MENDIMET	NGADHËNJIM NË NJË LOJË	QË I KA RËNË TË FIKËT; I	EPOKA E RE	1			
KËNGËTARJA DHE MODERATORJA NË FOTO 1											I ZË ME DORË				
MEKANIZËM I THJESHTË, QË SHËRBEU PËR TË LEHTËSUAR NGRITJEN E PESHAVE						JETË PA TRAZIME (shq.) ISH PRESIDENTI SHQIPTAR RAMIZ									
I UJITA							I MORALSHËM FUTBOLLISTI FRANCEZ TIERI								
ANALISTI SHQIPTAR MUSTAFA				I GDHENDA E THAVA											
ELIZABETH TAYLOR			LËNDË MËSIMORE	REGJISORI HALILI GRUMBULLIM (sh.shq.)			ZHANËR I MUZIKËS (origj.) KRYEQYTETI I AZERBAJXHANI								
FUQI, FORCË					POLITIKANI SHQIPTAR IMAMI RIFAT AVDIU						PEIZAZHI I GJERË				
ZANORE		PORTIERI KASILLAS METAFORA E GJATË				INDIA, ARMENIA PJESE E KËMISHËS (sh.shq.)			ORHAN PUNAJ ZANORE		FATALIZËM	AKTORJA ITALIANE BELLUÇI MOSHË E RE	TRANSFER MULTISORT ELEKTRONI	ZANORE	
KALORËS JAPONEZ							ARKA PREJ HEKURI KU RUHEN PARA ISH ATLETI AMERIKAN MONTGOMERI								
TËRËSIA E KUSHTEVE METEOROLOGJIKE					LETËR E FORTË NË BIXHOZ BASHKËTING.				I NJËZËSHËM DY BASHKËTINGËLLORE					SEKTË I VEÇANTË I MYSLIMANËVE	
AGJENCIA EVROPIANE			ZANORE INDIUM, ELEKTRON	MJET PËR TË RRËSHQITUR MBI BORË INTENSITET, TITAN			KËPUCË ME RROTULLA PËR TË RRËSHQITUR HOLLË, JO TRASHË								
EPOKA E RE	KËNGËTARE E JONA GRUP MUZIKOR				EMËR MASHKULLI MYSLIMAN SHKRONJË GREKE					PIJE ALKOOLIKE QË NXIRRET NGA MUSHTI I RRUSSHIT KLINT ISTVUD				ZANORE EKZEMPLAR I VETËM	
AFTËSI E PAGIMIT (treg.)							BASHKËTING. FIGURË SHAHU		FORTESË AKTORI MUÇAJ					"URUGUAI" PRINCIPATË ARABE (sh.shq.)	
MURG I VETMUAR						MASË NDËSHKIMORE (shq.) PASION PËR T'U VËNË ZJARRIN OBJEKTEVE						KËNGËTARJA JONË E RE ... KOÇI OHAJO, PENNSILVANIA			
NORA ISTREFI			ZANORE BASHKËTING.	PANDJESI, LIMONTI EVERTON					NUKLEAR NJËRI NGA AKUZUESIT E SOKRATIT (shq.)						
SHKRIMTARI ALIGHIERI					ISLANDA, MALTA FEMRA LUFTËTARE (mit. greko.)			MARC ANTHONY E VËNGËR (sh.shq.)			GJINI E KRIJIMTARISË LETRARE REGJISORI QOSJA				
												RADIUM, TON SHPEND ME QAFË TË GJATË (sh.shq.)			
							FUTBOLLISTI FETAHU EMËR I VJETËR PËR VIETNAMIN (shq.)					PËRFUNDIM NË SHAH FUTBOLLISTI ARGJENTINAS JUAN SEBASTIAN		LLOJ BUKE	
								TEPSI BALTE (sh.shq.) HISTORIANI ROMAK LUKRECI					BASHKËTING. TINARI		
				MJESHTERIA, PROFESIONI							PARA TË NËNTËS GURRA				
				MËNYRË ARTIFICIALE E EPSHIT						PUNIM I ARËS					
				BEREQET (krah.)						KOHË BASHKËTING.				"RUANDA" BASHKËTING.	
				ANDORA	ISMET TOTO				STADIUMI I KLUBIT MILAN "... SIRO"					NDËRTESE PRANË UDHËS QË SHËRBEUNTE SI BUJTINË	



ZGJIDHJA E FJALËKRITIT: D. ENEDA TARIFA, MAKARA, IDILI, I VADITA, ETIK, NANO, I LATOVA, DANTE, IM, MA, EPIKA, ARAGONIT, RAT, MO, ENIS, PAT, HAMAM, TAVAT, S. ZANATI, E TETA, ONANI, ARATIM, NIMET, MOT, RU, A, IT, SAN, HAN, KALA, UR, EREMIT, DENIMI, ENI, NI, E, APATI, ATOMIK, DANTË, IM, MA, EPIKA, ARAGONIT, RAT, MO, ENIS, PAT, HAMAM, TAVAT, S. ZANATI, E TETA, ONANI, ARATIM, NIMET, MOT, RU, A, IT, SAN, HAN, M.

Kërkesa për shprehje të interesit
Emri i shkollës: **"Salih Bytyçi" - Shkozë**
Komuna: **Malishevë**
Data: **4.11.2019**

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/056-CS/1.6	Trajnimi i mësimdhënësve për Gjithpërfshirje

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP)*, dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles **"Salih Bytyçi" - Shkozë - Malishevë**.

Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme:

- Trajnimi i mesimdhënësve për Gjithpërfshirje

Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme;
- Përvojë në trajnimin dhe punën me personelin arsimor
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.
- Liqenca e akreditimit për trajnimet e cekura.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

- Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatesisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën Gjithpërfshirjes

Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha trajnimi i mësimdhënësve (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve Trajnimi i mesimdhënësve për Gjithpërfshirje (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).

Firmat konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën: shfmu **"Salih Bytyçi" - Shkozë - Malishevë**, më së largu deri më 12.11.2019

Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

Detajet kontaktuese të shkollës:
Personi kontaktues: Arben Bytyçi, Tahir Sopaj
Telefoni: 044536234 ,049641126
E-maili: beni-1988@live.com

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

CV

www.facebook.com/gjeipuneshpejite

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Ismet Ujkan Uka shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII, SHF "Shotë Galica" Runik.
- Valmir Ajeti shpall të pavlefshme diplomën e SHFM "Anton Çetta" Skenderaj.
- Fadil Alija shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren
- Angjellko Pacollaj shpall te pavlefshme dëftesat e vitit I,II shme "Ymer Prizreni" Prizren
- Angjellko Pacollaj shpall te pavlefshme dëftesat e vitit III dhe diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren
- Bekim Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Motrat Qiriaz" Prizren
- Urgjentisht kërkohet një banesë për blerje ne Prishtine me dy dhoma gjumi. Informatat në tel: 044 741 155.
- Lëshohet shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkudjesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- Lëshohet banesë me qira, banesa është ndërtime i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- Lëshohet banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- Lëshohet banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- Lëshohet garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- Urgjentisht kërkohet një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- Lëshohet lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- Lëshohet banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshohet banesë me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- Lëshohet banesë me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- Lëshohet banesë me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshohet banesë me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshohet banesë me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshohet banesë e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshohet banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- Lëshohet banesë një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Lëshohet me qira banesë e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.
- Lëshohet banesë me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.
- Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.
- Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.
- Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783
- Lëshohet banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.
- Kërkoj dy bashkëbanuese, mundësisht të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përball Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së, ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesën mund ta shihni çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.
- Shesim banesë dy dhomshe në Ulpiana D8 h3 Nr 15 kati 3 ndërtime i vjetër, e rinovuar komplet, me nxemje të qytetit , çmimi 77 000€. Informatat tel:049/400-958 dhe 044/627-387



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government



Ministria e Mbrojtjes
Ministarstvo Odbrane / Ministry of Defense
Drejtoria e Burimeve Njerëzore / Direktorat Ljudskih Resurs
Human Resources Directorate

KONKURS

**PËR REKRUTIMIN E KADETËVE PËR SHKOLLIM NË AKADEMINË E FORCAVE AJRORE
DHE AKADEMINË USHTARAKE –WEST POINT TË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS**

Afati i konkurimit:

Konkursi është i hapur prej 22.10.2019 deri më 04.11.2019.

**Ministria e Mbrojtjes iu shërben të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës
dhe mirëpret aplikacionet e të gjithë kandidatëve të interesuar
pa dallim gjinie, race dhe përkatësie etnike.**

Konkursi dhe formularët për aplikim janë në dispozicion në Komandën e Forcave Tokësore
dhe në ueb-faqen e Ministrisë së Mbrojtjes, www.mod.rks-gov.net.
Për informata plotësuese, mund të kontaktoni në nr.tel. 038-603-355.

